



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:  
“Mësues për Arsim Fillor”  
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Dr. OGERTA KORUTI STROKA**

**Dr. Marsela ROBO**

**Shtator 2024**

**Tabela përmbledhëse për programin e studimit në Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në: “Mësues për Arsim Fillor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr. 542, datë 09.11.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 64, datë 14.06.2018 miratuar me shkresë të MASR Nr. 7238/1 Prot, datë 31.08.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 349, datë 22.10.2020 IAL ka kërkuar në QSHA korrigjimin e urdhërit lidhur me numrin e krediteve, përmes shkresës me Nr. 933 Prot., datë 01.06.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023	2022-2023 13 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 60 studentë 2022-2023 45 studentë

19	Komente / të tjera:	-
----	---------------------	---

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) është krijuar me VKM Nr. 801, datë 20 dhjetor 2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Për herë të parë Universiteti Aleksandër Moisiu i hapi dyert në tetor të vitit 2006. UAMD është akredituar me VBA nr. 18, datë 24.03.2022. Në vitin e parë akademik, në Fakultetin e Edukimit (FE) kanë ndjekur studimet 354 studentë dhe deri më sot FE numëron 1877 studentë të diplomuar në programe të ciklit të parë, dhe 737 studentë të diplomuar në programet e ciklit të dytë.

Fakulteti i Edukimit (FE) është një nga pesë njësitet kryesore të UAMD. Ky fakultet synon të arrijë standarde akademike bashkëkohore në rangun kombëtar, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore të cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë. Fakulteti i Edukimit ofron nëntë programe bachelor dhe 10 programe master i shkencave dhe master profesional.

Departamenti i Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit është një prej pesë njësive bazë të Fakultetit, që ofron pesë programe nga të cilët tre programe të ciklit të parë bachelor dhe dy programe master ku një është program Master Profesional dhe një program Master i Shkencave. Departamenti përbëhet nga 13 anëtarë PAE, të gjithë me grada dhe tituj shkencor, si dhe gjashtë 6 anëtarë PAK, për vitin akademik 2022-2023. Ky departament është njësi bazë që ka përgjegjësinë të ofrojë programin e studimit Master Profesional i cili synon arsimimin e studentëve në fushën e mësimdhënies në arsimin fillor. Ky program gjendet dhe në IAL të tjera publike dhe private në Shqipëri, megjithatë UAMD është përpjekur të sigurojë vijimësinë e këtij programi prej disa vitesh. Për t'ju përgjigjur nevojave të tregut shqiptar për mësues të arsimit fillor, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me Urdhërin Nr.542, datë 9.11.2012, "Për hapjen e disa programeve të reja të studimeve në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës", pika 1/b, lejoi hapjen e programit të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mësuesi për Arsimin Fillor Kl. I – IV", me 120 kredite dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës . Për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, Më pas ky Program, është riorganizuar me Vendim Senati Nr.1031/1, datë 05.07.2018 dhe miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7238/1 prot, datë 31.08.2018, në Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor".

Që nga fillimet e tij, ky program ka pësuar ndryshime të qënësishme duke qenë se Departamenti i Pedagogjisë është përfshirë seriozisht në procesin e akreditimit të programit në përputhje me Standardet e Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Qëllimi kryesor i programit është të përgatisë studentë të aftë për t'ju përshtatur kërkesave të reja të tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vend, duke i pajisur ata me njohuri të qëndrueshme në fushën e tyre të studimit, gërshetuar dhe me metodat bashkëohore të mësimdhënies edhe me mjete të reja teknologjike. Programi ndërthur aftësitë teorike me ato

praktike të zhvilluara këto në institucionet e arsimit parauniversitar në perputhje me marrëveshjet e vazhdueshme që ky program ka me Drejtorinë Arsimore Rajonale në Durrës. Programi herë pas here përditësohet në drejtim të rritjes së cilësisë së ofertës akademike e cila bazohet në përvojën më të mirë të universiteteve shqiptare dhe atyre evropiane. Mobilitetet ku janë përfshirë stafi akademik dhe studentët kanë luajtur një rol kryesor në përditësimin e këtij programi master profesional. Pavarësisht ideve, planeve dhe përpjekjeve të bëra mund të konstatohet se njësi bazë, njësi kryesore dhe drejtimi i IAL-së duhet të zhvillojnë strategjitë e duhura për rekrutimin dhe mbajtjen e PAE cilësor dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e lëndëve dhe sillabuseve të përshtatur me nevojat e tregut dhe praktikat më të mira në mësimdhënie.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga vizitat në institucion, GVJ-ja vlerëson vëmendjen që pedagogët dhe strukturat drejtuese i kushtojnë studentëve jo vetëm nga asistenca akademike por edhe në trajtimin e shqetësimeve të tyre. Gjithashtu, nëpërmjet një mjedisi universitar të ndërtuar dhe konceptuar në formën e një korpusi me ambiente bashkëkohore, me klasa të pajisura me mjete teknologjike me klasa të mëdha, të ajrosura dhe me dritë natyrale, synohet që studentët të kenë mundësi të ndihen në kushte komode për zhvillimin e mësimin dhe përgatitjen e tyre profesionale. Vlerë e shtuar e ambienteve janë edhe lehtësitë që ofrohen për studentët me aftësi ndryshe si rampat dhe ashensori.



## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, UAMD, ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit të studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL. Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018. Për programin e studimit ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAMD, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Dr. Marsela Robo** dhe **Prof. As. Dr. Ogerta Koruti Stroka**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Znj. Anilda Beqiraj.

Vizita në UAMD u realizua në datën 07 dhe 08 Nëntor 2023. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, ju vu në dispozicion një sallë ku u zhvilluan të gjitha takimet e parashikuara sipas agjendës. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me: Përgjegjësin e Departamentit, Dekanin e FE, GVB, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, zyrën e Burimeve Njerëzore, Stafin e Zyrës së Alumni dhe Karrierës, Stafin e Zyrës së Projekteve etj. GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas axhendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse dhe njëkohësisht kanë kërkuar dokumentacion shtesë që mbështetsin aktivitetet dhe procedurat e ndryshme të zhvilluara në UAMD dhe më konkretisht në Departamentin e Pedagogjisë në FE. GVJ, pasi rishikoi dokumentacionin e plotë dhe në reflektim të takimeve që pati në institucion, paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave, standarteve dhe kriterëve përkatëse, për programin e studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”. Në fund të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, janë përfshirë nëpërmjet një analize, pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit, si dhe rekomandimet që kanë dalë nga procesi i vlerësimit të jashtëm. Raporti i mëposhtëm është është një sintezë e vlerësimit të programit të studimit nga dy ekspertet e vlerësimit të jashtëm. Pas vizitës, GVJ hartoi raportin e vlerësimit, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vetëvlerësimit, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL.

**Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, është njohur me DRVJ më datë 24.07.2024, përmes sistemit AMS, formë zyrtare me shkresë Nr 19/112 Prot date 24.07.2024. Universiteti nuk dërgon komente . Në këtë mënyrë DRVJ merr formën përfundimtare si RVJ.**

**Lista e shkurtimeve**

UAMD- Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës

FE- fakulteti I Edukimit DVV-Dosja e Vetëvlerësimit

DP -Departamenti i Pedagogjisë

ECTS-European Credit Transfer System

GVB- Grupi i vlerësimit të brendshëm

GVJ - Grupi i vlerësimit të jashtëm

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

NJSBC-Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

PAE- Personel Akademik Efektiv

QSHA-Qendra e Shërbimeve Arsimore

RVB-Raport i Vlerësimit të Brendshëm

STP-Studimi i Tregut të Punës

SZhFE- Strategjia e Zhvillimit të Fakultetit të Edukimit

SZhUAMD- Strategjia e Zhvillimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës

MAF –Mësues për Arsim Fillor



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

### “Mësues për Arsim Fillor”

#### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Referuar Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), si edhe duke u mbështetur në dokumentacionin shoqërues në Dosjen e Vetëvlerësimit, (DVV), Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se Universiteti i Durrësit (UAMD) është themeluar me VKM Nr. 801 datë 20.12.2005. Referuar Planit Strategjik të Zhvillimit të UAMD (2020-2025), thuhet se Misioni i UAMD-së, është, “të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit” si edhe “të mbështesë prioritet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit”.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të Dytë Master Profesional në “Mësues për Arsimi Fillor” që ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë, pjesë e Fakultetit të Edukimit në UAMD është hartuar dhe implementuar në përputhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• Nenin 74, të Ligjit Nr. 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore;</li><li>• Statutin e UAMD dhe Rregullore e UAMD dhe programit të studimit;</li><li>• VKM nr 801 dt. 20.12.2005 “Për vendimin e hapjes së UAMD”;</li><li>• Urdhër Nr. 542, datë 09.11.2012 “Për hapjen e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi për Arsimin Fillor” me kohëzgjatje 2-vjeçare.</li></ul> <p>Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatjen e programit</p>






	<p>Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” pranë Departamentit të Pedagogjisë, me Vendim Senati Nr.67, date 14.06.2018 dhe miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7238/1 prot, datë 31.08.2018.</p> <p>GVJ vëren që programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. UAMD ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, si dhe janë konform ruajtjes së vlerave kulturore kombëtare.</p> <p>Statuti i Ri i UAMD-së përkatësisht në Nenet 3 dhe 4, në Kodin e Etikës të UAMD-së dhe në Rregulloren e re të UAMD-sënë Nenin 16, pika 2. shpreh qartë se Fakulteti i Edukimit, mbështetet mbi përgjegjshmërinë dhe ofrimin e parimeve e vlerave që shërbejnë si bazë e ndërtimit të një shoqërie solide duke ndërthurur traditat më të mira në fushën e arsimit, me qasjet e reja bashkëkohore në mësimdhënie. Ndaj Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”, shpreh qartazi që në mënyrën e hartimit të tij, mbështetjen në përvojën akademike e kulturore, ndaj kërkesave të kohës dhe perspektives së zhvillimit të vendit dhe synon ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konstaton se Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” i ofruar nga Fakulteti i Edukimit UAMD, në përgjegjësi të Departamentit të Pedagogjisë është program i Ciklit të Dytë të studimeve, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS). Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, përshtatjen e programit Master Profesional në “Mësuesi për Arsimin Fillor” pranë Departamentit të Pedagogjisë, me Vendim Senati Nr.67, datë 14.06.2018 dhe miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7238/1 prot, datë 31.08.2018.</p> <p>Vizioni i UAMD, është përgatitja e studentëve që do të jenë lider në fushën e edukimit, kërkimit dhe zhvillimit, si dhe ofrimi i shërbimeve shoqërisë shqiptare duke ofruar zgjidhje për problemet konkrete me të cilat ajo përballet. Gjithashtu, fushat e</p>



	<p>studimit të programeve të ofruara përputhen me drejtimet e kërkimit shkencor në UAMD. studentit me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit, me aftësim drejt një profesioni. Së bashku me synimet e tjera të detajuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloren për Praktikant Profesional del e qartë se ky program studimi është hartuar në harmoni me misionin dhe objektivat e UAMD-ja, të përshkruara qartë në Statutin e UAMD-së dhe Planin e Zhvillimit Strategjik (2020-2025).</p> <p><i>Evidencë 1 Statuti UAMD, 2018</i></p> <p><i>Evidencë-3 - Rregullore UAMD 2018</i></p> <p><i>Evidenca 4 - Kodi i Etikës të UAM</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pd</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, GVJ konstaton se Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” është program i ciklit të dytë të studimeve, i organizuar me kohezgjatje normale dy vite akademike dhe me një total prej 120 Kreditesh (ECTS), i cili ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë, FE. GVJ konstaton se Neni 1 i Rregullores për Organizimin e Programit të Studimit, përcakton se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin e UAMD-së, Planin e Zhvillimit Strategjik të UAMD (2020-2025) dhe Rregulloren për organizimin e programit të studimit. GVJ konstaton se Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat e Planit të Zhvillimit Strategjik të UAMD, Statutin dhe Rregulloret e Universitetit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p> <p><i>Evidencë-3 - Rregullore UAMD 2018</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” ka si qëllim të të përditësojë njohuritë teorike të studentëve duke ju referuar praktikave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare. Në përshtatje edhe me kërkesat e tregut të punës ky program ka si qëllim të të pajisë studentët me aftësi teorike dhe praktike si edhe të përditësojë aftësitë e tyre kërkimore duke</p>

të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.

i përafëruar me standartet ndërkombëtare. Ky program është konceptuar duke patur marrë në konsideratë strategjitë kombëtare por edhe ato të rrethit, gjë që rrit besueshmërinë në tregun e punës dhe e rikonfirmon UAMD-në si një universitet lider.

Pas vizitave dhe pas njohjes me dokumentacionin mbështetës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se:

- Departamenti i Pedagogjisë që ofron këtë program studimi, është krijuar në vitin 2009 dhe ka një eksperiencë 14 vjeçare në mësimdhënie në këtë program studimi;
- Departamenti i Pedagogjisë ofron programe studimi në gjuhën shqipe aktive në dy ciklet, ciklin e parë Bsc dhe ciklin e dytë të studimit Master Shkencor;
- UAMD dhe konkretisht Fakulteti i Edukimit ofron 8 programe Bachelor dhe 11 programe Master Shkencor dhe programe master professional;
- Departamenti i Pedagogjisë ofron 5 programe nga të cilët; 2 programe Bsc, 2 programe Master Profesional dhe 1 program Master i Shkencave;
- Infrastruktura në funksion të Fakultetit të Edukimit është bashkëkohore dhe e pajisur me teknologjinë e fundit, si tablea interaktive, projektorë dhe sistem audio. Kampusi ku zhvillohet mësimi është relativisht i ri dhe me hapësirat e nevojshme. Në dispozicion të studentëve ka një sallë Biblioteke e pajisur me tituj bashkëkohorë, interent dhe mjete teknologjike;
- Stafi akademik është i motivuar dhe i kualifikuar. Departamenti i Pedagogjisë për vitin akademik 2022-2023 ka në dispozicion 13 PAE të gjithë me tituj dhe grada shkencore.

Programi Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” ofruar nga Departamenti i Edukimit, është riorganizuar në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend pas një studimi tregu mbi nevojat e tregut të punës.

*Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf*

	<p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF. pd</i></p> <p><i>Evidencë 129 Raport vleresimi mbi performancën e lektoreve full-time - Departamenti i Pedagogjisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 58. Vendimet për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 73. Infrastruktura në funksion të programit të studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 87. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 16.1 Studim tregu model - Master Arsim Fillor 2013.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga FE e UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi Master Profesional në "Mësues për Arsim Fillor" i përmbush më së miri misionin dhe objektivat e UAMD, të shprehura në të gjitha dokumentat e tij. Ky program studimi ruan interesat dhe vlerat kombëtare.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demon-stron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë i cili është krijuar në vitin 2009 dhe ka një eksperiencë 14 vjeçare në mësimdhënie në programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimit.</p> <p>Departamenti organizon dhe menaxhon me përgjegjshmëri programe studimi, të cilat përmbajnë njohuritë themelore teorike dhe aftësi praktike në shkencat pedagogjike dhe metodologjike. Departamenti ofron këto programe:</p> <p>a) Bsc Arsim Fillor</p> <p>b) Bsc Arsim Parashkollor</p>

- c) MP Didaktikë
- d) MP Arsim Fillor
- e) Msc Menaxhim dhe Supervizim i Institucioneve Arsimore

Departamenti i Pedagogjisë përbëhet nga 13 anëtarë nga të cilët:

- a) 1 Prof. Dr.
- b) 7 Prof. Assoc. Dr
- c) 5 Dr.

Stafi akademik i Departmentit të Pedagogjisë i përfshirë në këtë program studimi i kushton rëndësi pjesëmarrjes në projekte, kërkimit shkencor, si dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesë e stafit akademik të DP janë pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies, si edhe staf më i ri që kanë përfunduar me sukses studimet pasuniversitare jashtë shtetit. Burimet njerëzore dhe infrastrukturore janë të mjaftueshme për zhvillimin në normalitet të procesit mësimor si edhe ka një qëndrueshmëri të kuadrit akademiks edhe një raport të përshtatshëm midis brezave të ndryshëm të personelit akademik. Fakulteti i Edukimit zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarine akademike në Godinen Nr. 1, Kampusi Universitar, Spitalë. Në këtë Fakultet procesi mësimor kryhet 15 auditore me kapacitet total 1141 vende dhe me sipërfaqe 1374.2 m<sup>2</sup> dhe 1 laborator me kapacitet 64 vende dhe sipërfaqe 81.8 m<sup>2</sup>. Gjithashtu ka në dispozicion 16 zyra me sipërfaqe totale 483.9 m. Për aktivitete të ndryshme ka në dispozicion një sallë konferencash me kapacitet 218 vende me sipërfaqe 192.2 m<sup>2</sup>. Fakulteti ka në dispozicion një bibliotekë me kapacitet 126 vende, me sipërfaqe 238.8 m<sup>2</sup>. GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni si dhe nga takimet e zhvilluara me stafet drejtuese dhe stafin akademik, vlerëson se stafi ka pjekurinë, maturinë dhe motivimin për të realizuar me sukses këtë program studimi.

*Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv ne njesine baze.pdf*

	<p><i>Evidencë 80- Baza e kerkimit shkencor Artikuj &amp; Konferenca shkencore - Departamenti i Ped. 2019-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 73. Infrastruktura ne funksion te programit te studimit.pdf</i></p> <p><i>Evidence 44 - Ngarkesa mesimore e Personelit Akademik - Departamenti i Pedagogjise 2020-2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 44.1 Ngarkesa Mesimore e Personelit Akademik 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mesimore e personelit akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 6. Struktura Organizative e UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Departamenti i Pedaogjisë është hartuesi dhe zbatuesi i Programi i Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” ofrohet nga DP i Fakultetit të Edukimit UAMD. Programi i studimit është program i Ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS).</p> <p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse.</p> <p>Stafi akademik përgjegjës për realizimin e këtij program studimi, është një staf në masën 100% me grada dhe tituj shkencorë.</p> <p>Programi i studimit është riorganizuar pranë Departamentit të Pedagogjisë, me Vendim Senati Nr.67, date 14.06.2018 dhe miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7238/1 prot, date 31.08.2018, mbështetur edhe në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke patur si referencë gjithashtu nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, Udhëzimin Nr.1 datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si edhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, i ndryshuar”, VKM-në Nr.41 datë 24.01.2018</p>

	<p>“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, si edhe duke respektuar liritë dhe detyrimet akademike të personelit akademik dhe të studentëve.</p> <p>Mbështetur në Udhëzim 31 dt 15.11.2022, “Për Procedurat Për Kodifikimin nga IAL në RSH”, institucioni ka dorëzuar evidencë 11.2 mbi kërkesën për Kodifikimin e programeve të studimit drejtuar Dekanit të Fakultetit të Edukimit.</p> <p>Institucioni ka dorëzuar dhe një evidencë (11.1 11.2 Kodifikimi i UAMD), ku Rektori i UAMD i drejtohet MAS për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga ky institucion, por në këtë shkresë kodifikimi i programeve të Fakultetit të Edukimit nuk është përfshirë edhe pse drejtuesja e njësisë bazë e ka përcjellë informacionin për kodifikimin e programeve GVJ vlerëson se informacioni i dhënë është i pamjaftueshëm për të vlerësuar këtë proces kaq të rëndësishëm.</p> <p><i>Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv ne njesine baze.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11.2 Kodifikimi i programeve te departamentit te pedagogjise.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” i ofruar nga Fakulteti i Edukimit UAMD, është përgjegjësi e Departamentit të Pedagogjisë. Programi i studimit është program i Ciklit të dytë të studimeve, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me një total prej 120 kredite (ECTS).</p> <p>Ky program merr kryesisht studentë nga dy programet Bsc që ofron vet Departamenti i Pedagogjisë, por dhe nga programet e tjera Bsc të ofruara nga Fakulteti i Edukimit. Ky program studimi është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Rregullorja e Programit të Studimit përcakton mënyrat e ndarjes së ngarkesës mësimore, disiplinat formuese, infrastrukturën mësimore si edhe personelin akademik përgjegjës. Gjithashtu, në rregullore përcaktohen me saktësi mënyra e vlerësimit dhe e diplomimit të studentit, si edhe syllabuset e lëndëve. Sistemi i krediteve është i njëjtë me sistemin european ECTS.</p>



	<p><i>Evidencë 11.2 Kodifikimi i programeve te departamentit te pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11 Kodifikimi UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 63 Ligji i Arsimit të Lartë nr.80, dt.22_07_2015.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 42.3 Model Silabusi.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 42.3 Model Silabusi.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program Master Profesional në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë nuk ofrojnë programe studimi Master Profesional jashtë profilit të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Zyra e Alumnit, Karrierës dhe Komunikimit funksionon në Institucion në nivel qendror. Kjo zyrë bën të mundur mbajtjen e komunikimit me studentët Alumni pas përfundimit të programit të tyre të studimit. Ashtu sikurse edhe na u komunikua nga përfaqësuesja e kësaj zyre, gjatë ditëve të takimeve, herë pas here studentët Alumini kontaktohen me forma të ndryshme komunikimi në varësi të nevojave të institucionit. Në dokumentet mbështetese, Institucioni ka dorëzuar disa të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve pas përfundimit të programit. Evidenca 26.1 ka të dhëna për vendin e punësimit të rreth 645 studentëve të diplomuar nga UAMD. Nuk ka informacion për zhvillime trajnimesh pas përfundimit të studimeve.</p> <p><i>GVJ nuk mund të shprehet mbi punësimin e studentëve për këtë program studimi për sa kohë institucioni nuk jep të dhëna të sakta për studentët e diplomuar në programin Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”.</i></p> <p><i>Evidencë 22. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 26.1 Të dhëna ALUMNI për punësimin e studenteve të UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ mbështetur në evidencat e dorëzuar dhe vizitat në institucion me Zyrën e Komunikimit, Karrierës dhe Alumnit vëren se</i></p>



	<p><i>program i studimit ofrohet nga një Departament që është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë dhe asaj kryesore. Nuk ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me kodifikimin.</i></p> <p><i>GVJ nuk mund të shprehet mbi përqindjen e të punësuarve nga ky program pas diplomimit. Në takimin e zhvilluar u theksua se 90% e të diplomuarve janë punësuar por nga dokumentat e dorëzuar, nuk shohim të përfshirë alumni të këtij program studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues në DVV, konstatohet nga GVJ, se në funksion të realizimit të programeve të tij të studimit, UAMD ka hartuar strukturën organizative, në të cilën përcaktohet vendosja e detyrave apo aktiviteteve që lejon funksionimin e duhur të çdo departamenti, me synimin e ofrimit dhe sigurimit të cilësisë në kuadër të realizimit të programit të studimit. UAMD ka hartuar rregullore të institucionit, rregullore të fakultetit, rregullore të çdo programi studimi, politika, procedura, udhëzues dhe manuale, përmes të cilave mbikëqyr mbarëvajtjen e programeve. Në këto dokumenta përshkruhen të gjitha proceset, ashtu sikurse janë të ndara detyrat e stafit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ.</p> <p>Bazuar në Statutin e UAMD, Fakulteti Edukimit, është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura. FE e mbështet veprimtarinë në Rregulloren e tij ashtu sikurse edhe DP. Veprimtari e Programit</p>

	<p>të Studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” mbështetet në Rregulloren e hartuar për këtë program.</p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqërues GVJ konstaton se UAMD, pjesë e të cilit është edhe FE, ka nënshkruar 76 Marrëveshje Bashkëpunimi me institucione dhe kompani të ndryshme 40 prej të cilave janë nënshkruar me Institucione të Arsimit të Lartë jashtë vendit. Deri tani, janë 13 programet e Bashkimit Europian që po zbatohen në UAMD, 7 prej të cilëve projekte TEMPUS, 5 projekte të rritjes së kapaciteteve në IAL dhe 1 projekt nga programi Europe for Citizens si dhe është pjesë e Erasmus Mundus Action 2.</p> <p>Këto marrëveshje mbështesin stafet akademike, ndihmës akademike dhe studentët në mobilitete për ndjekje të studimeve për një semester apo më gjatë, praktika mësimore, mundësi mësimdhënie apo shkëmbime profesionale. FE është pjesë e projekteve ndërkombëtare e më konkretisht DP është pjesë e projektit "Preparing future teachers in the Eastern Balkans: Education for democracy and human rights" miratuar nga Këshilli i Evropës dhe drejtuar nga Qendra Evropiane Wergerland. Ky projekt është i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. DP koordinon projektin për UAMD Inclusive Tertiary Education in the Western Balkans (IDEA). Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian (Erasmus+ dhe CBHE), (2021-2024). Po ashtu, GVJ konstaton nga vizita në institucion se FE ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe, Drejtori Arsimore, shkolla private të ndryshme, si edhe me aktorët e biznesit.</p> <p><i>Evidencë 119 Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus. UAMD 2015-2021 .pdf</i></p> <p><i>Evidencë 121-ANALIZË VJETORE 2021-2022.pdf</i></p>




	<i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e prog-rammit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët dhe stafin, se UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave dhe praktikave profesionale të programit të studimit (<i>Referuar Marrëveshjeve të Bashkëpunimit</i>).</p> <p>Nga 172 Marrëveshje Bashkëpunimi që janë paraqitur 21%, janë tashmë të përfunduara.</p> <p>Në Evidencë 67, bashkëpunimi me ZVA Durrës i përket vitit 2020-2021. <i>Institucioni duhet të paraqesë dokumenta që tregojnë bashkëpunimin e rëndësishëm me këtë institucion për vitin aktual 2022-2023 dhe në vazhdim.</i></p> <p>Falë marrëveshjes së nënshkruar me Departamentin e Pedagogjisë të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Krakovës, Poloni, janë reflektuar edhe ndryshime në programin e studimit të ciklit të tretë. Praktikrat mësimore zhvillohen në Bashkinë Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Arsimore Durrës.</p> <p><i>Evidencë 53 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.pdf</i> <i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.pdf</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti i Edukimit ka hartuar raporte analitike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, në kuadër të të cilave janë kryer edhe shumë aktivitete. Praktikrat profesionale, falë marrëveshjeve institucionale me drejtorië përkatëse arsimore, kryhen kryesisht në institucione arsimore publike.</p> <p><i>Evidencë 53 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.pdf</i> <i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vëren se ka mungesë dokumentacioni për sa i përket marrëveshjeve dhe kohëzgjatjeve të tyre (rasti me marrëveshjen</i>

	<i>me DAR- Durrës). Ka mungesë pasqyrimi të marrëveshjeve me bizneset vëndase. E megjithatë, gjatë vizitave në institucion, stafi akademik na njohu me projektet që ata individualisht apo si departament zhvillonin. GVJ u njoh me një grup studentor të cilët shprehën kënaqësinë e tyre që janë pjesë e këtij programi studimor, vlerësuan pjesëmarrjen e tyre në projekte të përbashkëta me profesorët e tyre, mundësinë e mobiliteteve por edhe realizimin e praktikës profesionale në shkollat e qytetit, edhe pse marrëveshja me ZVA është e përfunduar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				x

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” është hartuar në përputhje me Ligjin 80/2015.  Programi i studimit mbështetet me sistemin e Bolonjës dhe gjen zbatim me anë të Rregullores së Programit të Studimit. Planet mësimore janë të hartuara në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe janë të shkruara qartë kreditet për çdo lëndë sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), lloji i lëndës, semestri/viti akademik kur jepet lënda, orët mësimore, metodologjia, kriteret e vlerësimit etj. Vlerë e shtuar është edhe pajisjave e planeve mësimore me sistemin amerikan të krediteve (USCr), gjë që lehtësohn

transferimin/ vijueshmërinë e studimeve në universitete ndërkombëtare.

Ky program studimor është organizuar bazuar në nenin 73, pika 1, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me 120 kredite (ECTS) në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi në total me një kohëzgjatje prej 2 vitesh ose 4 semestra.

Në planin mësimor të programit të studimit, çdo vit akademik është i organizuar në dy semestra me një ngarkesë të barabartë prej 30 ECTS për çdo semestër, ose 60 ECTS në një vit akademik, me një total prej 120 ECTS. Plani mësimor përmban të gjithë veprimatrinë formuese të përcaktuar nga shtojca nr. 1, VKM nr. 41 datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Ky program është organizuar me lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe lëndë plotësuese si dhe detyrimet përmbyllëse. Veprimtaria formuese e programit të studimit është e përcaktuar, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019, dhe % dhe kreditet përputhen me VKM.

<b>Kategoria</b>	<b>Tipi i komponentit mësimor</b>	<b>Master i Profesional sipas shtojcës 1, VKM</b>	<b>Ofruar nga programi</b>
A	Lëndë bazë	5% -10% (6-12 kredite)	10% (12 kredite)
B	Lëndë karakterizuese	30% -40% (36-72 kredite)	35% (42 kredite)
C	Lëndë ndërdisiplinore/ integruese	20% -30% (24- 36 kredite)	25% (30 kredite)



	D	Lëndë Plotësuese	10% (12 kredite)	10% (12 kredite)
	E	Detyrime përmbyllëse	10% -20% (12-24 kredite)	20% (24 kredite)
<p>Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, konstatojmë se veprimtaria formuese e programit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji.</p> <p><i>Evidencë 31.3 Udhezimi nr. 31 dt. 29.12.2017.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf Neni 23, 42, 43</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-12-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41 dt.24.1.2018.</i></p> <p><i>Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mësuesi arsim fillor, MP 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p>				
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,</p>	<p>Në fokus të programit të studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, është përgatitja e punonjësve arsimor të cilët mund të thellojnë studimet e tyre deri në ciklin e tretë doktoratë</p> <p>Programi, ndër të tjera ka qëllim të ndikojë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në shkollat fillore. Ka një gërshetim të njohurive teorike me ato praktike, njohuri që do të ndikojnë në rritjen profesionale të mësuesëve të ciklit fillor. Lëndët janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të përfshijnë jo vetëm njohuritë teorike por edhe ato praktike si detyrat e kursit, prezantimet,</p>			

<p>zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>rastet studimore, shkrimi i një mikroteze. Në këtë mënyrë studentët aftësohen të mësojnë dhe të shprehën në mënyrë kritike dhe të jenë të aftë të përvetësojnë aftësitë soft, aq shumë të kërkuara në tregun e punës. Pas diplomimit, përfundimit të stazhit dhe liçensimit studenët kanë mundësi të punësohen në institucione shtetërore apo private, kombëtare ose ndërkombëtare. Vlerë e shtuar e këtij programi është edhe mundësia që kanë studentët të punësohen në DAR, ZA apo në pozicione shërbimi civile apo shtetërore si specialiste në zhvillim dhe hartim kurrikulash. Referuar silabuse vihet re se ato përditësohen periodikisht me literaturë bashkëkohore.</p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf 60-62</i></p> <p><i>Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-12-Për Elementët e Programeve të Studimit, VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018. Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë-3.1.1.3 - Rregullore e programit të studimit Master Profesional "Mësuesi për Arsim Fillor", 2019.</i></p> <p><i>Evidencë 16.1 Studim tregu model - Master Arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-3.1.1 -Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë. 2019.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Ky programi i jep mundësi studentëve të ndjekin praktikën përgjatë dy semestrave në dy vite, të ndarë ndërmjet orëve në auditor dhe orëve në institucione të ndryshme arsimore të sektorit publik. Ky program nuk përmban praktikë laboratorike ose klinike por praktikë shkollore e zhvilluar nga klasa e parë deri në klasën e pestë në shkollat publike.</p>



	<p><i>Evidencë 102. Rregullore e praktikës profesionale.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 100. Manual i praktikës profesionale.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi i, që formojnë Mësuesi të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi i për formimin e Mësuesi ve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Praktika mësimore pasqyrohet qartë në programin e studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, me kreditet përkatëse bazuar dhe në aktet nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program vjen si një cikël i dytë studimesh pas studimeve të ciklit të parë në Bsc si Arsim Fillor, apo Arsim Parashkollor të ofruara nga vet Departamenti i Pedagogjisë. Programi është hartuar bazuar në studimin e kryer për nevojat e tregut të punës. Duke vlerësuar dosjen e këtij programi studimi si dhe duke u bazuar në diskutimet e realizuara gjatë vizitës në IAL dhe komunikimit me pedagogët e lëndëve të këtij programi, GVJ konkludon se ky program studimi synon që të zhvillojë studentët me njohuri profesionale, të nevojshme për fushën e Mësuesisë në arsimin fillor.</p> <p><i>Evidencë-43-Vendim nr.26 për Ndryshimin e Kurrikulave të Programeve që Ofrojnë Praktika Mësimore, 2019.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf Kreu III, Neni 60 pika d.</i></p> <p><i>Evidencë 16.1 Studim tregu model - Master Arsim Fillor 2013.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e Mësuesi së organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë Mësuesi të së njëjtës fushë të Mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të</p>	<p>Të gjitha elementet pjesë përbërëse të një programi studimi, mbështetur edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi janë pjesë e Programit të studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”. Dosja është e plotë dhe pjesë e saj janë: Rregullorja e njësisë kryesore e Fakultetit të Edukimit, Rregullorja e programit Master Profesional “Mësuesi Arsim Fillor”, kurrikula mësimore me disiplina, planin mësimor me të detajuar me temat përkatëse, metodologjinë e mësimdhënies, menyrën e vlerësimit etj.</p> <p>Referuar Programit të Studimit, përcaktohen qartë veprimtaritë formuese dhe lëndët janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara: bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese</p>




kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.

dhe detyrime përmyllëse të shprehura qartë me orë në auditore, jashtë auditorit dhe me kreditet përkatëse. 60 kredite ofrohen në vitin e parë dhe 60 kredite në vitin e dytë të studimeve.

Programi i studimit "Master i shkencave" ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara

Lëndët e kategorisë A (5-10%) -12 kredite ( zënë 10 % te krediteve)

Lëndët e kategorisë B (30-40%) - 42 kredite ( zënë 35 % te krediteve)

Lëndët e kategorisë C (20%-30) - 30 kredite( zënë 25 % te krediteve)

Lëndët e kategorisë D (10%) -12 kredite ( zënë 10 % te krediteve)

Lëndët e kategorisë E (10-20) - 24 kredite ( zënë 20 % te krediteve)

Ngarkesa e këtyre komponentëve mësimorë është në përputhje me VKM nr.41, dt.24.01.2018

Lëndë të tilla si: Zhvillim kurrikule, Metoda e mësimdhënies, Mendimi kritik në mësimdhëni, edukimi special etj janë lëndë karakterizuese për një program të tillë mësuesie.

Duke u bazuar në dosjen e këtij programi studimi dhe konstatimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, mund të konkludojmë se ky program studimi përmban elementet e nevojshëm që lejojnë krijimin e strukturës së tij. Kurrikula e programit të studimit hartohet nga departamenti dhe më pas miratohet nga Dekani i FE-së si dhe nga Senati i UAMD-së.

Në lidhje me ngjashmërinë e këtij program, në RVB nuk kemi ndonjë informacion në lidhje me programet e ngjashme dhe ngjashmërinë me to. GVJ me informacionin që zotëron e ka të vështirë të konkludojë për këtë pikë të kriterit 5.

*Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf*

*Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf.*

	<p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf, Seksioni IV, 24.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 57_60 Kriteret e pranimit te studenteve &amp; Shperndarja e kuotave.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 58. Vendimet për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 60.2 Shpërnarja e Kuotave të pranimit të studenteve.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Procedura e pranimit dhe e regjistrimit të studentëve është e përcaktuar në Statutin e UAMD. Kuota e studentëve për programin e studimit propozohet nga Senati akademik dhe miratohet nga Bordi i Administrimit. Programi i studimit ofrohet në gjuhën shqipe. Studentët që përfshihen në këtë program studimi duhet të kenë grumbulluar 180 ECTS nga studimet e mëparshme. Dokumentat që studenti duhet të dorëzojë janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit. Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor”, është organizuar bazuar në nenin 73, pika 1, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve, me 120 kredite (ECTS) në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi në total me një kohëzgjatje prej 2 vitesh ose 4 semestra.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Referuar Raportit të GVB, Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, është ofruar për herë të parë për studentët në vitin akademik 2012-2013. Që nga ai vit programi ka pësuar ndryshime dhe ka përmbajtje të ngjajshme me programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi mbi 70%.</p> <p>E megjithatë nuk ka dokumentacion mbështetës në dosjen e dokumentave ndaj GVJ nuk mund të shprehet për këtë kriter.</p>

<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Mbështetur në Udhëzim 31 dt 15.11.2022, “Për Procedurat Për Kodifikimin nga IAL në RSH”, institucioni ka dorëzuar evidencë 11.2 mbi kërkesën për Kodifikimin e programeve të studimit drejtuar Dekanit të Fakultetit të Edukimit. Institucioni ka dorëzuar dhe një evidencë (11.1 11.2 Kodifikimi i UAMD), ku rektori i UAMD i drejtohet MAS për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga ky institucion, por në këtë shkresë kodifikimi i programeve të Fakultetit të Edukimit nuk është përfshirë edhe pse drejtuesja e njësisë bazë e ka përcjellë informacionin për kodifikimin e programeve. GVJ vlerëson se informacioni i dhënë është i pamjaftueshëm për të vlerësuar këtë proces kaq të rëndësishëm.</p> <p><i>Evidencë 11.2 Kodifikimi i programeve te departamentit te pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11 Kodifikimi UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 11.2 Kodifikimi i programeve te departamentit te pedagogjise.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program ofrohet nga Fakulteti i Edukimit UAMD, konkretisht nga Departamenti i Pedagogjisë. Ky departament nuk ofron programe të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë. Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, mbulohet në masën 90% nga lëndë që mbulohen departamenti i Pedagogjisë; 10% e lëndëve mbulohen nga Departamenti i Psikologjisë dhe ai i Sociologjisë.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në të dhënat e paraqitura, konstatojmë se veprimtaria formuese e programit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji. Veprimtaria formuese e programit të studimit është e përcaktuar, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24.01.2018, të ndryshuar me VKM nr. 879 datë 18.12.2019. Studimi i tregut është i vjetëruar (viti 2013).</i></p> <p><i>GVJ vlerëson se ky kriter përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

**Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Fakulteti i Edukimit, pjesë e UAMD bazon veprimtarinë në statutin e tij sipas ligjit në fuqi (*L. 80/2015, Neni 22, pika 1*). FE është njësia kryesore dhe ka keto departamente

- Departamenti i Gjuhës Shqipe;
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja;
- Departamenti i Letërsisë;
- Departamenti i Pedagogjisë;
- Departamenti i Psikologjisë;
- Departamenti i Sociologjisë;
- Qendra e Edukimit në Vazhdim;

Departamenti i Pedagogjisë është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor, Ai përmbush të gjitha detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike si dhe vlerësimin e akreditimin. Njësia bazë ka mision dhe vizion të qartë, të cilat i bazon në politikat dhe planin strategjik të institucionit. Ndër të tjera, këtë e mbështesim edhe në përputhjen mes rregullores së studimit në nivel fakulteti dhe dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për arsimin e lartë. Stafi i Departamentit përgjegjës për programin e studimit në tre vite akademike ka kualifikimin e mëposhtëm:

<b>Departamenti i Pedagogjisë</b>						
<b>Titulli/Grada</b>	<b>2020-2021</b>		<b>2021-2022</b>		<b>2022-2023</b>	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-	1	-	1	-
Prof.Asoc.	4	2	5	1	7	-
Dr	6	1	6	-	5	-
Msc	-	-	-	-	-	-



	<b>Gjithsej</b>	<b>11</b>	<b>3</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>13</b>	<b>0</b>
	<p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf Kreu VII, Neni 77 - 81</i></p> <p><i>Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv ne njesine baze.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-61-Kodi i Cilësisë.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-12-Për Elementët e Programeve të Studimit. VKM-Nr.-41-dt.24.1.2018. Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</i></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p><b>Programi i studimit Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë dhe nuk angazhon personel akademik ndihmës për mbikqyrjen e praktikës mësimore. GVJ vëren se grupi i vlerësimit të brendshëm në RVB është shprehur se ky program studimi për shkak edhe të specifikave të veçanta (Mësuesit nuk kanë pse kryejnë orë laboratorike) nuk ka orë laboratorike dhe klinike dhe për këtë arsye nuk ka të përfshirë staf akademik/administrativ ndihmës. Praktikave mësimore të shtrira në të dyja vitet akademike realizohen në shkolla, sipas marrëveshjeve me DAR Durrës.</b></p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf Kreu VI, Neni 72.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf. Kreu X, Neni 80.</i></p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor. MP 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf Kreu III, Neni 60, pika d</i></p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo</p>	<p><b>Bazuar në RVB e cila bazohet në Evidencë 3 &amp; 3.1, roli i kordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e ecurisë së programit Master Profesional “Mësues</b></p>						

<p>program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>për Arsim Fillor” sipas rregullores së Universitetit, rregullores së Departamentit dhe programit të studimit i takon drejtuesit të departamentit të Pedagogjisë.</p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i> <i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kriteret ligjore, ka në përbërje të saj 13 pedagogë me kohë të plotë të cilët zotërojnë grada dhe tituj shkencorë.</i></p> <p><i>Programi i studimit, nuk ka orë laboratorit të programuara në asnjë nga lëndët e ofruara, si rrjedhojë nuk ka staf ndihmës akademik të angazhuar për realizimin e orëve të laboratorit. Ndjekja e praktikës profesionale bëhet nga vet pedagogët. Koordinator i Programit të Studimit është Përgjegjësi i Departamentit.</i></p> <p><i>GVJ mendon se rolin e koordinatorit të programit të studimit duhet ta mbajë një PAE pasi Departamenti ka 5 programe dhe Përgjegjësi i Departamentit ka dhe detyra të tjera dhe smund të jetë coordinator në të 5 programet.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.3**


**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e UAMD-së, Rregulloren e Fakultetit të Edukimit, Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë, Rregulloren e Programit të Studimit, Kurrikulën e programit të studimit, Planin mësimor dhe më tej në sillabuset e lëndëve këtij programi të grupuara në përputhje me kategoritë e veprimtarive formuese ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë programi i</p>



<p>dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”. Ky departament është përgjegjës për dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij.</p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor. MP 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” shoqërohet me silabuset përktëse, të hartuara në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Të përfshira në to janë informacione të rëndësishme si titulli i veprimtarisë formuese, kategoria e veprimtarisë (A - E), kreditet e lëndëve frekuentimi, ngarkesa e orëve, semestrin kur zhvillohet lënda, mënyr e vlerësimit. Vlerë e shtuar e programit është edhe vlerësimi më sistemin amerikan krahas atij shqiptar, gjë që krijon lehtësira për studentët që duan të transferojnë apo të ndjekin studimet jashtë vendit. Kurrikula përmban 15 module si dhe praktika profesionale dhe provimi formimi/Mbrotje teme të shpërndara në 2 vite me nga 2 semestra. Secila lëndë vlerësohet me numrin e krediteve (6 kredite). Për llogaritjen e krediteve është marrë parasysh ngarkesa e çdo moduli ku një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore + pune të studentit, në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në <i>VKM nr. 41 dt. 24/01/2018 (Pika 2.1.b)</i>. Totali i krediteve plotëson numrin total të krediteve prej 60 ECTS në çdo vit akademik dhe konkretisht 30 ECTS në çdo semester.</p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf. Seksioni VIII, Neni 73.</i></p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 52.1 Tabela e ngarkeses vjetore per vitin 2021-2022 f-t.pdf</i> <i>Evidencë 52.2 Ngarkeses vjetore 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë-12-VKM nr.41-Për Elementët e Programeve të studimeve</i></p>

	<p><i>Evidencë 12 - VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 51 Vendim Senati për Miratimin e Ngarkesës Mësimore Realizuar nga Personeli Akademik me Kohë të Plotë dhe të Pjesëshme.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor, MP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program mbështetet në:</p> <p>Rregulloren e UAMD-së;</p> <p>Rregulloren e Fakultetit të Edukimit;</p> <p>Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë;</p> <p>Rregulloren e tij;</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, janë të specifikuar qartë në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë, Kreu III, Neni 35, pika 4, Nenet 41, 42, 43, 44, 45.</p> <p>Studentët kanë mundësi të informohen rregullisht mbi këto kritere edhe përmes faqes zyrtare të UAMD-së në hapësirën Studenti. Lajmërime që kanë në qendër studentin vendosen në rrjetet zyrtare sociale të institucionit dhe përcillen edhe në postat e tyre elektronike (emaile) email. Gjithashtu, gjatë vizitave GVJ vuri re se mjediset e Institucionit ishin të pajisura me tabela ku ishin të vendosura lajmërime të ndryshme që i vinë në ndihmë studentëve.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf KREU III, Neni 56.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf. Neni 20, 98.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/">https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore</p>	<p>Në planin mësimor, për secilën lëndë, është dhënë kategoria e lëndës, kreditet, ndarja e orëve në një javë (teori, praktikë dhe totali i orëve), orët e studimit gjatë gjithë semestrit (leksione, praktika, , punë individuale, të tjera dhe totali). Është përcaktuar,</p>

<p>(syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>praktika mësimore në vitin e parë dhe të dytë të studimit në semestrin e dytë, si lëndë me detyrim dhe cikli i studimit përmbillet me provim formimi/mbrojtje teme.</p> <p>Në syllabusin e secilës lëndë janë përcaktuar orët e aktiviteve mësimore: teori, praktikë. Në sillabus janë dhënë dhe elementët e tjerë si literatura, mënyra e vlerësimit, tematikat, objektivat e të gjitha elementët përbërës së sillabusit etj.</p> <p>Syllabuset janë të përditësuara dhe kanë pjesë të tyre të gjitha elementët përbërës të tyre sipas këkresave të aktive ligjore.</p> <p>Ato kanë gjithë informacionin që i nevojitet studentëve mbi lëndët përkatëse, ku përfshihen: përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit, objektivat e lëndës, konceptet themelore që do të trajtohen, kalendarin javor me temat përkatëse, formën e kontrollit të dijeve si dhe literaturën përkatëse, që është specifike për çdo lëndë. Duke lexuar sillabuset studentët njihen me: emrin e pedagogut të lëndës, numrin e krediteve sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, numrin e orëve në auditor dhe orëve për studim individual jashtë auditorit, tipologjinë e lëndës, vitin akademik dhe semestrin akademik kur mund të ndiqet lënda, llojin e lëndës: e detyruar ose me zgjedhje si dhe adresën e emailit të pedagogut të lëndës. Syllabuset hartohen dhe përditësohen nga pedagogët përgjegjës përpara fillimit të semestrit dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë bazë, i cili merr miratimin e grupit mësimor dhe kërkimor-shkencor për sillabuset të cilat mbulojnë nga ky grup. Studentët njihen me këto sillabuse (programet lëndore), në orët e para të zhvillimit të lëndës, nga pedagogët përkatës.</p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 42.3 Model Silabusi.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni por edhe gjatë vizitave GVJ konstatoi se FE dhe veçanërisht DP ka hartuar instrumente për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në ndihmë të këtij procesi vinë pyetësorët e vlerësimit të lëndëve nga studentët, nga formularët e vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik, Alumni,</p>

<p>ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>institucione dhe bizneseve me të cilat ka bashkëpunime. Në dokumentat që GVJ i ishin vënë në dispozicion ishte vetëm versioni në gjuhën shqipe i dosjes.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor, MP 2022.pdf</i></p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vleresimit te programit nga studentet.docx</i></p> <p><i>Evidencë 71. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se Programi Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, është i detajuar dhe strukturuar në funksion të objektivave të programit të studimit. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Studentët marrin informacion në shumë medime. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm kjo falë edhe bashkëpunimeve me aktorë të ndryshëm.</i></p> <p><i>Me përjashtim të praktikës profesionale dhe provimit të formimit/mbrojtjes së temës, të gjitha lëndët kanë të përcaktuara orët e leksionit, orët e seminarit dhe orët për studim individual. Në programin e studimit, angazhohen një numër i konsiderueshëm Prof. assoc. Dr dhe Dr.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi II.4**




**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Lëndët e ofruara në programin e studimit, përmbushin objektivat e programit të studimit. Programi Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, përfshin lëndët bazë: Metoda të Kërkimit Shkencor në Edukim dhe Shkenca Edukimi, lëndë këto që thellojnë njohuritë e studentëve në fushën e Mësuesisë.</p> <p>Lëndët karakterizuese si: Vlerësimi i Kurrikulës, Komunikimi dhe Etika, Metodatat e Mësimdhënies, Mendim Kritik në Mësimdhënie, Edukim Special, Edukim Qytetar Demokratik i japin mundësi studentëve të përditësojnë njohuritë e tyre me lëndë specifike për profesionin e tyre të ardhshëm. Duhet theksuar se edhe lëndët ndërdisiplinore si: Politikat dhe Legjislacioni në Arsim, Lidërshipi në Edukim, Pedagogji Sociale, Psikologji Edukimi, Histori e Arsimit dhe Mendimit Pedagogjik, Edukimi Mjedisor dhe Teknologjitë në Edukim i pajisin studentët me aftësi soft që do t’i duhen si Mësuesi i ciklit fillor. GVJ është e mendimit se modulet e paraqitura si dhe përmbajtja e tyre janë në përshtatje me aftësimin e studentëve me njohuritë përkatëse që kërkohen sot nga tregu i punës.</p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit është i shpërndarë në dy vite akademike, me dy semestra secili vit, me një ngarkesë totale 120 ECTS, ku në çdo vit akademik dhe semestër ka një shpërndaje të barabartë të krediteve.</p> <p>Lëndët që janë pjesë e programit të studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” aftësojnë studentët si nga ana teorike ashtu edhe ajo praktike duke ju dhënë mundësi atyre të bëhen specialistë në fushën e mësimdhënies në arsimin fillor. Kështu, lëndët bazë të detyrueshme e pajisin studentin me njohuri metodologjike ndërkohë që lëndët karakterizuese ju japin mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre.</p>

	<p>Nga shqyrtimi i objektivave të programit të studimit dhe syllabuset e lëndeve konstatohet se programi mundëson arritjen e objektivave. Studentët e Masterit Shkencor në MSIA, zhvillojnë aftësi dhe kompetanca në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- metoda që përdoren në/për kërkim shkencor;</li> <li>- aftësitë në mësimdhënie;</li> <li>- aftësi në komunikim;</li> <li>- lidërsip;</li> <li>-mendimin kritik dhe mënyrën integrale të përfshirjes së tij në mësimdhënie;</li> <li>- vlerësimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve;</li> <li>- arsimin gjithpërfshirës;</li> <li>- përdorimin e teknologjive të reja në mësimdhënie/nxënie;</li> </ul> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p>															
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” shtrihet përgjatë katër semestrave, ku lëndët janë me nga 6 kredite secila ndërkohë që detyrimet përmbyllëse janë 24 kredite. Programi ofron një raport të teorik-praktik të mbështetur në programe të ngjashme ndërkombëtare. Programi i studimit Master i Shkencave, është i organizuar në orë leksioni dhe seminari sipas strukturës më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 1361 1388 1536"> <thead> <tr> <th>Orë</th> <th>V.I</th> <th>V.II</th> <th>Totali</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksion</td> <td>240</td> <td>120</td> <td>360</td> <td>66%</td> </tr> <tr> <td>Praktikë/seminar</td> <td>120</td> <td>60</td> <td>180</td> <td>33%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Konstatohet se raporti teori -praktikë, për vitin e parë të studimit është 66 teori dhe 33 praktikë. Ky raport ruhet dhe në vitin e dytë. Bazuar në Rregulloren e Universitetit dhe në Statutin e UMAD-së, semestri i rregullt përfshin 15 javë kalendarike për zhvillimin e veprimtarive formuese.</p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p>	Orë	V.I	V.II	Totali	%	Leksion	240	120	360	66%	Praktikë/seminar	120	60	180	33%
Orë	V.I	V.II	Totali	%												
Leksion	240	120	360	66%												
Praktikë/seminar	120	60	180	33%												



	<p><i>Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor, MP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaria formuese e programit të studimit është në përputhje me tabelën 1, shtojca 1, e VKM nr. 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar. Studentët mund të konkurojnë në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Mbështetur edhe në Marrëveshjet e lidhura nga UAMD studentët sipas thirrjeve Erasmus + apo projekte të tjera mund të aplikojnë të transferojnë studimet e tyre në universitete partnere, për një semester apo më gjatë.</p> <p>Njohuritë e përfuara gjatë 2 viteve akademike ju mundësojnë studentëve edhe vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve, doktoratë. Praktika mësimore është përcaktuar në semestrin e dytë dhe të katërt, si lëndë me vete, vlerësohen së bashku 12 ECTS, Gjatë semestrit të dytë dhe të katërt studentët zhvillojnë katër orë praktike në javë. Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se institucionet dhe kompanitë me të cilat bashkëpunohet për praktikën, janë të mjaftueshme për studentët e këtij program studimi për të vënë në zbatim njohuritë e përfuara në auditorë. Fakulteti ka memorandume bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Praktika, i vë në kontakt studentët me kërkesat e punëdhënësve, për aftësi dhe kompetenca të caktuara, krijon mundësi për ballafaqimin e njohurive të përfuara në auditor me kërkesat e tregut të punës dhe mundëson krijimin e kontakteve për mundësi punësimi në të ardhmen.</p> <p><i>Evidencë 119 Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus. UAMD 2015-2021 .pdf</i></p> <p><i>Evidencë 53 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124. Booklet UAMD.pdf Evidencë Broshura para Promovimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” ka 11 vjet që ofrohet nga UAMD dhe mbështetet në syllabuse që janë gjithmonë në përditësim edhe më literaturë bashkëkohore. Kjo literaturë, e detyrueshme apo e rekomanduar ju vihet në dispozicion studentëve në bibliotekën e fakultetit të Edukimit si edhe në bibliotekat online.</p> <p>Referuar raportit të GVB, kjo literaturë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe literatura e detyrueshme është e pesë viteve të</p>



<p>dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>fundit. <i>E megjithatë nga shqyrtimi i syllabuseve të vëna në dispozicion vëmë re se në shumë prej lëndëve literatura është e më shumë se 10 viteve të fundit. Modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e syllabuse-ve është modeli i përcaktuar në VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2).</i></p> <p>Ka programe lëndore ku literatura është e 20 viteve përpara, pra lind nevoja për një përditësim për të pasqyruar kërkesat dhe zhvillimet reale të tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Statuti dhe kuadri rregullator mbi të cilat funksionojnë njësitë e IAL-së pasqyrojnë qartë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015, Neni 76, 89, VKM, 2.7 kuotat e pranimit). Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve dhe kompetencave.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e vënë në dispozicion mendon se ky program studimor i përgatit studentët mjaftueshëm për kërkesat që ka tregu i punës. Referuar raportit të GVB, pas përfundimit të studimeve në programin Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor", studentët mund të ndjekin stazhin e detyruar e më tej t'i nënshtrohen provimit për pajisjen me Liçencën shtetërore. Studentët mund të punësohen në shkolla publike dhe jo-publike, nga klasa 1-5. Formimi i marrë në këtë program studimi u mundëson studentëve që kanë dëshirë të vijojnë më tej studimet përmes avancimit të kualifikimit deri në nivelin e trete të studimeve, drejt gradës "Doktor i Shkencave".</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf.Neni 60-62</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor", përgjithësisht i përgatit studentët për tregun e punës dhe njëkohësisht nëpërmjet krediteve të fituara ata mund</i></p>

	<i>të ndjekin ciklin e dytë të studimeve. Përmbajtja e programit të studimit i ofron garanci studentëve në përditësimin e dijeve dhe aftësive që kërkohen nga tregu i punës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5


**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Një nga prioritetet e UAMD-së është dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programeve që ky institucion ofron. Rishikimi dhe përditësimi i kurrikulave bëhet nga njësia bazë, Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, si dhe komisionet përkatëse dhe strukturat e Universitetit. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni por edhe gjatë vizitave GVJ konstatoi se FE dhe veçanërisht DP ka hartuar instrumente për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në ndihmë të këtij procesi vinë pyetësorët e vlerësimit të lëndëve nga studentët, nga formularët e vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik, Alumni, institucione dhe biznese me të cilat ka bashkëpunime. Për çdo vit akademik, bëhet analiza e punës të Departamentit të Pedagogjisë. Në bazë të analizës përcaktohen pikat e dobta dhe mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit. UAMD ka në strukturat e saj dhe Zyrën e Karrierëse cila mban kontakte të vazhdueshme me Alumni. Alumni kanë dhe një shoqatë si dhe kryejnë aktivitete apo takime. Gjithashtu Departamenti i Pedagogjisë ka kontakte nëpërmjet stafit dhe me Institucionet ku studentët kryejnë praktikat profesionale.</p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vlerësimit të programit nga studentet.docx</i></p>

	<p><i>Evidencë 71. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 21 - Rregullore - Udhezuesi_i_Karrieres.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në vendimmarrje në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015.</p> <p>Studentët kanë përfaqësues të tyre në Senat si dhe në komisione të tjera të ngritura në rang Universiteti. Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, studentët përcojnë shqetësimet në Njësinë bazë dhe atë Kryesore. Studentë kanë përfaqësuesin e tyre në komisione të ndryshme ku mund të shprehin mendimet e studentëve për përmirësimin e programeve të studimeve dhe jo vetëm. Këto mendime dhe sugjerime ndikojnë në përmirësimin e sillabuseve, metodave të mësimdhënies literaturës shtesë në fushën e mësimdhënies. Gjithashtu, për çdo vit akademik, hartohen pyetësorë për studentët, me qëllim që të merret mendimi i tyre, për përmirësim të mëtejshëm të lëndëve. Referuar takimeve me përfaqësues ng Zyra e Karrierës, Departamenti i Pedagogjisë mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar në këtë program studimi nëpërmjet emaileve dhe telefonave. UAMD ka në strukturat e saj dhe Zyrën e Karrierës e cila mban kontakte të vazhdueshme edhe me Alumni. Alumni kanë dhe një shoqatë si dhe kryejnë aktivitete apo takime. Gjatë vizitave në institucion, GVJ takoi përfaqësues të kësaj zyre dhe u interesua për të dhënat që ky sektor disponon.</p> <p>Referuar raportit të GVB por edhe takimeve me stafin akademik, Departamenti i Pedagogjisë, organizon diskutime të hapura për të sjellë risi në këtë program. Studentët gjejnë mbështetje nga Koordinatorin e programit për çdo nevojë të tyre. Në takimet e zhvilluara nga GVJ u theksua se Departamenti i Pedagogjisë, konsultohet me Alumni në mënyrë që të përditësojë dhe përafrojë programin me kërkesat e tregut. Në UAMD funksionon dhe Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, që mban kontakte me studentët dhe ALUMINI dhe i orienton ata sipas kërkesave të tyre.</p> <p><i>Evidencë 146. Perfaqesimi i studenteve ne Senatin Akademik.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf Kreu IX, Neni 88.</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar.pdf.</i></p> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf, 2020-2021, 2021-2022.</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vleresimit te programit nga studentet.docx</i></p> <p><i>Evidencë 21 - Rregullore - Udhezuesi i Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 22. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.pdf</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga Dokumentacioni i administruar, Fakulteti i Edukimit ka marrëveshje aktive bashkëpunimi, të cilat shërbejnë jo vetëm për realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi potenciale për punësimin e studentëve, por dhe si mundësi për të diskutuar përmirësimin e programit të studimit dhe rishikimin e kurrikulës. Për programin e studimit departamenti ka organizuar takime me përfaqësues të institucioneve publike/ private në kuadrin e aktiviteteve ekstrakurikulare. E megjithatë, nuk ka ndonjë evidencë konkrete mbi ndryshimet e programit që kanë ardhur si rezultat i rekomandimeve nga studentët apo institucionet ku këta studentë atashohen për praktikën profesionale.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UAMD në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi ka planifikuar politikat e brendshme, kamhartuar aktet rregullatore, ka ngritur strukturat përkatëse dhe vë në zbatim veprimtari për të siguruar pjesëmarrjen e studentëve në vendmarrje. Shumë të rëndësishëm janë për institucionin alumni, të cilët ftohen në institucion për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët aktual.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.6**

**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, është një program 2 vjeçar që ofrohet nga Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, UAMD. Institucioni ka përcaktuar qartë objektivat e tij të cilat përputhen dhe me objektivat e progrmit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të ofrojë programe të një niveli të përparuar e bashkëkohor teorik, metodik e praktik;</li><li>- të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fusha që përmbushin nevojat e individëve dhe punëdhënësve duke i përgatitur të diplomuarit për tregun e punës;</li><li>- të tërheqë specialistët më të mirë dhe të inkurajojë me të gjitha mënyrat kontributin e tyre;</li><li>- të kryejë studime shkencore për të zhvilluar më tej dijen në profilet shkencore që lëvron;</li><li>- të ofrojë kualifikim të vazhdueshëm e bashkëkohor për personelin akademik në fushat që mbulon;</li></ul> <p>Programi i studimit ka përcaktuar qartë objektivat për t’i ofruar studentëve të regjistruar, rritje profesionale në karrierën e tyre si Mësuesi të ciklit të ulët.</p> <p><i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga vizitat dhe dokumentat e dorëzuar, GVJ vlerëson që Institucioni respekton lirinë akademike në mësimdhënie si dhe nxit stafin akademik në kërkim shkencor, në mobilitete apo në pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga takimet me stafin akademik, u pohua fakti që UAMD mbulon shpenzimet e stafit për botime kombëtare dhe ndërkombëtare në revista të rankuara në Scopus ose Factor Impakti si dhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca ndërkombëtare.</p> <p>UAMD si dhe njësia bazë, nxisin kërkimin shkencor cilësor dhe mbështesin stafin akademik në pjesëmarrje në projekte të ndryshme. UAMD është jo vetëm partner por dhe lider në disa projekte ndërkombëtare.</p>





	<p><i>Evidencë 77 Vendim Nr.384 Miratim i Rregullores së Menaxhimit të Aktiviteteve Shkencore dhe Akademike në UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 80- Baza e kerkimit shkencor Artikuj &amp; Konferenca shkencore - Departamenti i Ped. 2019-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124. Booklet UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit nxit dhe motivon studentët që të kërkojnë më shumë nga vetja e tyre, por edhe të përfshihen në debate konstruktive me pedagogët e tyre dhe me studentë të tjerë në programe të ngjashme. GVJ vlerëson gadishmërinë e stafit për nxitjen dhe angazhimin e studentëve në projekte kërkimore dhe aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e lidhshirë dhe menaxhimin e projekteve të ndryshme. Gjatë takimit me studentët përfaqësues të këtij programi studimor GVJ konstatoi lirshmërinë e tyre në diskutime, pohimin e studentëve që ata ndiheshin mirë që zëri i dëgjohej dhe që disa prej tyre ishin edhe të angazhuar në Këshillin Studentor dhe në disa projekte së bashku me pedagogët.</p> <p>Gjatë praktikave profesionale që zhvillohen në të dyja vitet akademike, në shkolla të ndryshme të qytetit të Durrësit kanë mundësi të vëzhgojnë orë mësimore reale nga Mësuesi me përvojë. Gjithashtu ata praktikohen më mësimdhënie në klasat e ciklit të ulët, sipas edhe nevojave të shkollave ku do të kryejnë praktikat e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ e ka përmendur dhe më lart në kriter 2, që UAMD është një universitet që mbështet fuqishëm kërkimin shkencor dhe stafin akademik në aktivitetet e tyre për rritjen profesionale. UAMD mbulon shpenzimet e stafit për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare si dhe botimet e tyre në revista të rankuara me Factor Impakti dhe/ose Scopus.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson mbështetjen financiare që UAMD i jep stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca apo botime ndërkombëtare. UAMD financon dhe projekte kërkimore shkencore.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.7

**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti në përputhje me, fushat kërkimore shkencore ciklet e studimit, disiplinat, etj, propozon grupet mësimore e kërkimore shkencore. (<i>Evidence 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise, neni 13</i>).</p> <p>Me mbledhje të posaçme propozon ndarjen e grupeve, si dhe lektorët përkatës duke iu referuar profilin dhe vijshmërisë së studimeve. Përgjegjësi i grupit mësimor organizon punën për hartimin e programeve të lëndës që i perkasin grupit mësimor, mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies kërkimeve shkencore, ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe informon drejtuesin e njësisë bazë.</p> <p><i>Evidence 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise, neni 13</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ mbështetur në <i>evidencë 2</i> vlerëson se UAMD ka synim nxitjen dhe mbështetjen e projekteve kërkimore të stafit akademik dhe njëkohësisht përfshirjen e studentëve në këto projekte, pasi integrimi real i mësimdhënies me kërkimin shkencor është një domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar. UAMD synon realizimin dhe përfshirjen e studentit në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuar prej tij por edhe shndërrimin shkallë-shkallë të raportit “pedagog-student” në “udhëheqës-kërkues”, sidomos në nivelin master e doktoraturë. Objektiv strategjik është edhe përmbushja e kriteve për promovimin e personelit akademik dhe dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore. Për këtë kriter GVJ është shprehur edhe me sipër, në standartin II-6- kriteri 3.</p>

	<i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Mbështetur në dokumentat e dorëzuara nga institucioni, GVJ vlerëson se institucioni ka një revistë që nxjerr në botim që nga viti 2014. Gjithashtu UAMD dhe stafi përfshihen në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. UAMD mbështet stafin me grante për pjesëmarrje në konferenca nderkombëtare apo dhe për botime ndërkombëtare në revista prestigjioze, duke mbuluar të gjitha shpenzimet e këtyre aktiviteteve.</p> <p><i>Evidencë 76 - RREGULLOREE KESHILLIT TE BOTIMEVE.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 80- Baza e kerkimit shkencor Artikuj &amp; Konferenca shkencore - Departamenti i Ped. 2019-2022.pdf</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Nga evidencat e dorëzuara nga Institucioni në lidhje me tregun e punës së zhvilluar për këtë program studimi, apo dhe evidencat në lidhje me punësimin dhe gjurmimin e studentëve Alumni, vihet re se studentët janë të punësuar si Mësues në ciklin fillor, dhe i vlerësojnë njohuritë e marra nga ky program studimi. Vlen të përmendim që studimi i tregut të punës duhet përditesuar (institucioni ka dorëzuar studim të bërë në vitin 2013), pasi kushtet dhe nevojat ndryshojnë dhe kjo do të ndihmonte stafin akademik për të propozuar ndryshime të ndryshme me qëllim përmirësimin e këtij program studimi.</p> <p><i>Evidencë shtesë - Gjurmimi i të punësuarve për studentët që kanë përfunduar këtë program studimi</i></p> <p><i>Evidencë 16.1 Studim tregu model - Master Arsim Fillor 2013.pdf</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së	<p>Nga takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, u vumë në dijeni që strukturat e ngritura në Fakultet dhe departamenti janë përherë të vëmendshëm ndaj ndryshime dhe akteve ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu ata janë kontakt të vazhdueshëm me strukturat drejtuese të DAR-eve dhe ASCAP për të qenë në dijeni të ndryshimeve që ndodhin e që kanë lidhje të drejtëpërdrejt me këtë program studimi. Me përfundimin me sukses të këtij program studimi, të diplomuarit duhet të ndjekin stazhin e më pas të japin provimin e licensimit.</p>

profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ vlerëson se program i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” është në një linjë me strategjitë dhe politikat e institucionit për mbështetjen, nxitjen dhe përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet trajnimeve të stafit dhe studentëve, nëpërmjet mbajtjes së marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët alumni si dhe kryerjen e studimit të tregut për përmirësimin e programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Bazuar në Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, “Për Organizimin e Studimeve” format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve bëhen nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• orëve të leksioneve</li> <li>• orëve të seminareve</li> <li>• orëve të integruara</li> <li>• projekteve/detyrave të kursit (individuale dhe/ose në grup); provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare;</li> <li>• praktikës profesionale</li> </ul>

- apo çdo formë tjetër të miratuar nga Njësia kryesore.

Në planin mësimor konstuam se:

1. Lëndët kanë një numër të njëjtë kreditesh dhe të njëjtën ngarkesë mësimore 150 orë në total të ndarë në orë në auditor dhe punë individuale. 1 kredit është i vlefshëm me 25 orë në total. Çdo lëndë ka 6 ECTS.
2. Lëndët me zgjedhje kanë të njëjtën ngarkesë dhe kredite si lëndët e detyrueshme. Plani mësimor është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Praktika profesionale zhvillohet në institucionet parauniversitare të ZVA -Durrës pas një marreveshje bashkëpunimi midis ZVA dhe UAMD.

Konstatojmë se kriteri ligjor i përcaktuar në pikën 2.1/b, VKM nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar, “një krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore pune studenti”, plotësohet.

Referuar raportit të GVB një tregues i rëndësishëm dhe me 10% peshë në vlerësimin përfundimtar është detyra e kursit e cila organizohet si punim individual apo si punë në grup. Pedagogët mundohen që të përfshijnë në realizimin e mini kërkime në grup, për t’i përgatitur edhe më tej deri në shkrimin e temës së tyre të diplomës. Megjithatë, nuk mungojnë edhe detyrat individuale, të formateve të ndryshme si ese, studime rasti, përmbledhje teorike etj. Në pjesën më të madhe të kurseve detyrat e kursit prezantohen në auditor, duke i dhënë mundësi studentëve të praktikojnë edhe të folurën në publik. Praktika shkollore e cila zhvillohet në semestrin e dytë dhe të katërt i jep mundësi studentëve të ushtrohen në klasa reale të gjitha njohuritë aftësitë, qëndrimet dhe vlerat e përfituara nga ky program studimi.

*Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf*

*Evidencë 34 - Plani Mësimor për Programin Master Profesional Mësues për Arsim Fillor.pdf*

*Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf. Neni 40,48 dhe Neni 60.*

*Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf*

*Evidencë 102. Rregullore e praktikës profesionale.pdf*

	<p><i>Evidencë 31 Dosja e programit MSh arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</b></p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se fusha e studimit dhe e specializimit e pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi, përputhet me lëndët me të cilat ata japin mësim. Pedagogët janë të angazhuar dhe në kualifikimin e vazhdueshëm. Institucioni ju ka dhënë mundësinë të përdorin dhe platformën Pitagora për të vendosur notat por jo vetëm. Disa prej provimeve mund të kryehen nëpërmjet Cleanscore në bashkëpunim me AADF. Klasat janë të pajisura së paku me video projektorë dhe kompjuter, por ka edhe klasa të pajisura me tabela interaktive të cilat ndikojnë ndjeshëm në procesin e mësimin.</p> <p>Stafi akademik pjesë e Departamentit janë lektorë dhe profesorë, me përvoja akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, falë kjo edhe nga marrëveshjet e nënshkuara si Universiteti i Wroclaw, Poloni, Universiteti Pedagogjik i Krakow, Poloni, Universiteti i Zadarit, Kroaci, College of Teacher Education Carinthia –Viktor Franki, Austri etj. Si rrjedhojë mësimdhënia është bashkëkohore, më në qendër studentin. Në të njëjtën kohë stafi akademik është pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shpeshherë në këto projekte në grupet e punës janë edhe studentët. Bazuar në vizitën në institucion, konstatohet se organizohen një sërë aktivitete që ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies por edhe aktivitete që mbështesin mësimin e vazhduar për studentët ALUMNI. Qendra e Edukimit në Vazhdim ofron trajnime për stafin akademik si dhe trajnime të akredituara (16 trajnime të njohura dhe licencuara nga ASCAP) me kredite për Mësuesit në kuadër të edukimit të vazhduar. Në vitin 2021-2022 janë zhvilluar 6 trajnime me stafin akademik të institucionit. Vetë stafi akademik organizon orë të hapura apo trajnime nga profesorët e FE.</p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit të Sistemi PITAGORA.jpg</i></p> <p><i>Evidencë 96 Përdorimi i CLEANSORE në Testime.pdf</i></p>



	<p><i>Evidencë 96. Perdorimi i Cleanscore.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 68. Mobilitet e stafit akademik dhe studenteve D.Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vleresimit te programit nga studentet.docx</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitave në institucion por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoi se Universiteti UAMD organizon trajnime për stafin akademik, me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Për vitin 2021-2022 janë zhvilluar 6 trajnime nga Qendra për Edukim të Vazhduar, me tema të ndryshme si: metoda novatore në mësimdhënie, platformat teknologjike në mësimdhënie, etika në mësimdhënie, vlerësimi i vazhduar etj. Për zhvillim dhe përmirësimin e vazhdueshm të stafit akademik, shumë të rëndësishme janë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit sidomos ato Erasmus+ në komponentin e mësimdhënies apo trajnimit. Pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar në mësimdhënie jashtë në kuadër të programit Erasmus +.</p> <p><i>Evidencë-137-Marrëveshje Bashkëpunimi për Programin Erasmus, UAMD. 2015-2021.</i></p> <p><i>Evidencë-43- Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD me Erasmus</i></p> <p>Evidencë shtese- Drejtoria e Administrimit dhe Sherbimeve Akademike MSH MSIA</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë</p>	<p>Profesorët e përfshirë në mësimdhënie si dhe në udhëheqjen e praktikave dhe të mikrotezave në programit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” kanë se paku gradën Doktor. Titullin “professor të asociuar” dhe një “Profesor”. Gjatë leximit të raportit vjetor kërkimor shkencor të profesorëve vihet re një nivel i lartë shkencor i përgatitjes së tyre referuar kumtesave, artikujve, trajnimeve dhe pjesëmarrjeve në projekteve kombëtare/ndërkombëtare. Këta profesorë janë ekspert në fushat e tyre dhe në lëndët që ata japin. Në çdo lëndë inkurajohet mendimi kritik dhe mendimi krijues, aftësi të cilat</p>



<p>kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>zhvillohen në klasë, gjatë detyrave individuale/në grup, diskutimeve, debateve apo prezantimeve. Studentët punojnë në mënyrë të pavarur dhe bëhen të përgjegjshëm për mësimnxënien.</p> <p>Gjatë bisedave me stafin akademik dhe grupin e studentëve por edhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton se profesorët bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe me studentët për punime dhe prezantime të përbashkëta të punimeve shkencore si në konferenca edhe në revista kombëtare/ndërkombëtare. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie si dhe përditësimi i sillabusit në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend, integrimi i kërkimit shkencor me mësimdhënien, janë objektiva të vendosura në misionin dhe planin strategjik të UAMD, të cilat reflektohen dhe në këtë program studimi në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktivitete të organizuar nga Departamenti në kuadrin e programit të studimit, përfshi dhe lektorë të huaj të ftuar;</li> <li>- Pjesëmarrja e stafit pedagogjik, për mësimdhënie dhe trajnime në kuadër të programeve të shkëmbimi si Erasmus +;</li> <li>- Vlerësimi i vazhdueshëm apo provime të ndërmjetme gjatë gjithë vitit.</li> </ul> <p><i>Evidencë-79-CV- Stafit Akademik</i></p> <p><i>Evidencë-120 - Titujt/Gradet shkencore te stafit</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Çdo vit akademik Departamenti i Pedagogjisë, raporton mbi procesin e mësimdhënies. Një ndihmë të madhe në këtë proces e japin edhe studentët e këtij programi me anë të plotësimit të pyetësorëve. Ky proces bazohet në rregullore të brendshme të vlerësimit të performancës së pedagogut (neni 61, 62, 109, 115) dhe është procesi mbi të cilin drejtuesit e Fakultetit të Edukimi dhe Departamentit të Pedagogjisë, verifikojnë shqetësimet e ngritura nga studentëve për të ndërtuar planin e punës për përmirësim të treguesve.</p> <p>Për secilin semester, bëhet vlerësimi i performancës individuale të pedagogëve, që japin mësim. Në këtë vlerësimim përfshihen disa rubrika që vlerësojnë njohuritë në lëndët të cilat pedagogu mbulon, materialet e kursit, metoda e mësimdhënies që</p>

	<p>përdoret, komunikimi që ka me studentët, kërkimi shkencor, botimet dhe kontributet akademike dhe mënyra e vlerësimit të njohurive. NJSBC si pjesë e detyrave të saj funksionale, vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me standartet e vendosura të cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E-rishikuar.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Në përmbushje të përcaktimeve të nenit 103, të ligjit 80/2015, UAMD ka ngritur njësinë për sigurimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë. Bazuar në Statutin dhe Rregulloren për Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për garantimin dhe sigurimin e cilësisë (KPGSC) është struktura përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, për hartimin e standarteve të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë që miratohet nga Senati akademik. Komisioni funksionon me rregullore të veçantë. Disa nga detyrat e këtij komisioni janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të zhvillojë politika dhe procedura për garantimin e cilësisë të brendshme;</li> <li>- të zhvillojë standarte për sigurimin e cilësisë;</li> <li>- të zhvillojë vlerësime periodike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;</li> <li>- të organizojë aktivitete trajnuese për zhvillimin profesional të stafit. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Senati Akademik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, konstatojmë se NJSBC, për përbushjen e detyrave të saj organizon në mënyrë periodike pyetësorë për studentët për secilën lëndë në të gjitha programet e studimit dhe të dhënat e përfituara dërgohen në Departament, sipas përcaktimeve të pikës 3 të ligjit 80/2015. Më pas DP analizon të dhënat dhe adreson gjetjet dhe problematikat.</li> </ul>

	<p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ vlerëson se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit të studimit Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor" përdor metoda të ndryshme bashkëkohore të mësimdhënies, duke përfshirë edhe teknologjinë me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Sfafi akademik është kompetent dhe ka kualifikimet e nevojshme për lëndët që mbulon.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.**


<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>	
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Për programin e studimit Master profesional, është e miratuar forma e kontrollit të njohurive, si më poshtë:</p>	
	Forma të kontrollit të njohurive	Programi i studimit Master Profesional
		Përqindja në vlerësimin total
	Detyrë kursi	10%
	Provim i pjesshëm	40%
	Provim përfundimtar	50%
Në total	100%	
<p>Në syllabusin e çdo lënde është përcaktuar, metoda e vlerësimit të kursit, dhe pesha që zë secili komponent në vlerësimin e</p>		

	kursit Bazuar në sillabus, frekuentimi i kursit është i detyrueshëm në masën 75%.			
	<i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pd</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i Raportit Vjetor por me shumë edhe nga vizita në institucion pedagogët informuan GVJ se në javët e para të mësimit në çdo semester, pedagogu përgjegjës informon studentët me detaje për lëndën duke vënë në dispozicion të tyre syllabusin.			
	<i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Depattamentit te Pedagogjise.pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në syllabuset, GVJ vëren se njohuritë testohen në forma të ndryshme dhe të vazhdueshme Komponentë të vlerësimit të vazhdueshëm janë detyrat e kursit me 10%, provim i ndërmjetëm 40 % dhe provim përfundimtar që ka një peshë 50%.			
	Kështu gjatë semesterit kur zhvillohet lënda, profesorët kanë mundësi të monitorojnë progresin e studentëve dhe të adresojnë boshllëqe apo paqartësi në njohuritë e tyre. Nga vizita në institucion, konstatuam se studentët takoheshin me profesorët për të diskutuar për paqartësi për kursin jo vetëm gjatë orëve të programuara mësimore por dhe sipas një orari konsultimi të mirëpërcaktuar.			
	<i>Evidencë 24.1 - Orari i konsultimeve me studentet.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Nga dokumentacioni i administruar dhe vizita në institucion, konstatojmë se, testimi i njohurive bëhet përmes vlerësimit të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit akademik. Universiteti ka investuar në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, ka hartuar procedura për vlerësimin e cilësisë të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Kontrolli i njohurive bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit.</p> <table border="1" data-bbox="611 638 1393 1066"><thead><tr><th data-bbox="611 638 1010 835">Forma të kontrollit të njohurive</th><th data-bbox="1010 638 1393 734">Programi i studimit Master Profesional</th></tr><tr><td></td><th data-bbox="1010 734 1393 835">Përqindja në vlerësimin total</th></tr></thead><tbody><tr><td data-bbox="611 835 1010 891">Detyrë kursi</td><td data-bbox="1010 835 1393 891">10%</td></tr><tr><td data-bbox="611 891 1010 947">Provim i pjesshëm</td><td data-bbox="1010 891 1393 947">40%</td></tr><tr><td data-bbox="611 947 1010 1003">Provim përfundimtar</td><td data-bbox="1010 947 1393 1003">50%</td></tr><tr><td data-bbox="611 1003 1010 1059">Në total</td><td data-bbox="1010 1003 1393 1059">100%</td></tr></tbody></table> <p>Bazuar në të dhënat e kësaj table, konstatojmë se provimi përfundimtar zë 50% të vlerësimin, detyra e kursit 10% të vlerësimin, provimi i ndërmjetëm 40% të vlerësimin.</p> <p>Në sillabusin e çdo lënde jepen në mënyrë të detajuar komponentet e vlerësimin që përdor secila lëndë, detyra kursi, si dhe pesha e çdo komponenti në përputhje me lëndën duke respektuar liritë akademike të profesoratit. Institucioni, ka hartuar udhëzues dhe rregullore për studentët, ku është përcaktuar se frekuentimi është i detyruar në masën 75%, si dhe sistemi i vlerësimin që përdoret për studentët e programit të ciklit të dytë të studimit.</p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p>	Forma të kontrollit të njohurive	Programi i studimit Master Profesional		Përqindja në vlerësimin total	Detyrë kursi	10%	Provim i pjesshëm	40%	Provim përfundimtar	50%	Në total	100%
Forma të kontrollit të njohurive	Programi i studimit Master Profesional												
	Përqindja në vlerësimin total												
Detyrë kursi	10%												
Provim i pjesshëm	40%												
Provim përfundimtar	50%												
Në total	100%												
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se për vlerësimin e pjesshëm dhe përfundimtar të studentëve përdoret platforma Pitagora. Sekretaria mësimore popullon me informacionin e nevojshëm platformën Pitagora. Në këtë mënyrë studentët marrin informacion për performancën e tyre akademike pa patur nevojë për të shkuar në Sekretarinë</p>												





	<p>Mësimore. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi për përdorimin e Clean Score, një korigjim i kompjuterizuar i shpejtë dhe i besueshëm i testimeve kryesisht me alternativa.</p> <p><i>Evidencë 96 Përdorimi i CLEANSCORE në Testime.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit të Sistemi PITAGORA.jpg</i></p>																																
<p><b>Kriteri 3. Vlerësimi</b> përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konkludon se zbatohen në mënyrë rigorozë, rregullat e kalimit të kursit dhe sistemi i vlerësimit, i pasqyruar dhe në Rregulloren e institucionit si dhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Në vlerësim përfundimtar përfshihen të gjithë komponentët e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit. Vlerësimi bëhet duke përdorur sistemin me notë dhe me gërmë. Studenti duhet të ketë frekuentuar kursin të paktën 75%. Vlerësimi bëhet bazuar në tabelën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="612 1077 1394 1659"> <thead> <tr> <th>Vlerësimi</th> <th>Përqindja %</th> <th>Pikët</th> <th>Nota</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A (Shkëlqyeshëm)</td> <td>94%-100%</td> <td>935-1000</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>B (Shumë mirë)</td> <td>85%-93%</td> <td>845-934</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>C+ (Mirë)</td> <td>76%-84%</td> <td>755-844</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>C (Mesatar)</td> <td>67%-75%</td> <td>665-754</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>D (I kënaqshëm)</td> <td>58%-66%</td> <td>575-664</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>E (Mjaftueshëm)</td> <td>51%-57%</td> <td>505-574</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>FX (Ngel)</td> <td>≤ 50%</td> <td>0-504</td> <td>4</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar në Rregullore, studentët që e kalojnë kursin me E ose notë 5 konsiderohen të suksesshëm. Një student që merr FX ose 4 për çdo modul, nuk konsiderohet i suksesshëm dhe duhet të përsërisë atë modul.</p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p>	Vlerësimi	Përqindja %	Pikët	Nota	A (Shkëlqyeshëm)	94%-100%	935-1000	10	B (Shumë mirë)	85%-93%	845-934	9	C+ (Mirë)	76%-84%	755-844	8	C (Mesatar)	67%-75%	665-754	7	D (I kënaqshëm)	58%-66%	575-664	6	E (Mjaftueshëm)	51%-57%	505-574	5	FX (Ngel)	≤ 50%	0-504	4
Vlerësimi	Përqindja %	Pikët	Nota																														
A (Shkëlqyeshëm)	94%-100%	935-1000	10																														
B (Shumë mirë)	85%-93%	845-934	9																														
C+ (Mirë)	76%-84%	755-844	8																														
C (Mesatar)	67%-75%	665-754	7																														
D (I kënaqshëm)	58%-66%	575-664	6																														
E (Mjaftueshëm)	51%-57%	505-574	5																														
FX (Ngel)	≤ 50%	0-504	4																														



	<p><i>Evidencë 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni, konstatojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studenti merr vlerësim dhe për detyrën e kursit, si dhe merr feedback të vazhdueshëm që në fazën draft dhe e përmirëson detyrën deri në versionin final që dorëzohet.</li> <li>- Studentët janë të informuar paraprakisht mbi datën e dorëzimit të detyrave, datën e zhvillimit të provimeve të ndërmjetme dhe atij përfundimtar.</li> <li>- Komunikimi i vlerësimit për çdo formë vlerësimi është i detajuar dhe bëhet në mënyrë individuale me çdo student. Nëse studentët nuk kanë ankimim për notën, vlerësimi përfundimtar hidhet në sistemin Pitagora.</li> </ul> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve, Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Referuar Raportit të GVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Studentët hyjnë në sallën e provimit me mjet identifikimi;</li> <li>- Në sallë nuk lejohet asgjë përveç tezës, dhe stilolapsave;</li> <li>- Tezat bëhen në katër grupe (një tezë është për 7-11 studentë);</li> <li>- Për çdo provim ka një komision prej dy pedagogësh;</li> <li>- Pedagogët duhet të sigurohen që fletët e provimit janë të plota dhe të kanë të vendosur kodin e provimit;</li> <li>- Nëse provimi është kryer me Clean Score ruhet anonimati i studentëve dhe teza korrigjohet me kodin unik për çdo student.</li> </ul> <p>Profesorët janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët për çdo detyrë të tyre dhe kështu kanë mundësi të garantojnë originalitetin e punimit dhe citimin e literaturës në mënyrën e duhur. <i>Vlen për t'u theksuar se institucioni nuk i ka vënë në dispozicion një platformë zyrtare për kontrollin e plagjaturës ndaj dhe profesorët nganjëherë detyrohen të përdorin aplikacione që ofrohen falas në web.</i></p>

	<p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf, Kreu III, Neni 70</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Studentët janë njohur me mënyrën e vlerësimit gjatë orëve të para të zhvillimit të lëndës. Gjatë semestrit studenti ka marrë pikët për detyrën e kursit dhe provimin e ndërmjetëm. Këtyre pikëve i shtohen dhe pikët e provimit përfundimtar dhe në fund del dhe nota përfundimtare.</p> <p>Rezultati i provimit përfundimtar i komunikohet personalisht studentit brenda 72 orëve nga dita e dhënies së provimit. Pasi janë bërë të ditura pikët, profesori sigurohet që studenti nuk ka paqartësi dhe ka dakordësi për vlerësimin, pikët e grumbulluara hidhen në sistemin Pitagora, ku nota përfundimtare del automatikisht. Çdo vonesë në lidhje me publikimin e rezultatit të vlerësimit ngarkon me përgjegjësi administrative komisionin e provimit. Afatet kohore dhe mënyra e komunikimit të notës, janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e UAMD dhe të programit të studimit të ciklit të dytë Master.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf, Kreu III, Neni 70.</i></p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit të Sistemi PITAGORA.jpg</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>provime dhe detyra</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me studentët gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se e drejta e studentëve për të ankimuar vlerësimin është respektuar. Ashtu sikurse na u pohua nga stafi dhe studentët, studentëve i komunikohet nota deri në 72 orë pas provimit, dhe aty mund të shohin edhe korrigjimin, rezultatin dhe notën e marrë. Pas dakortësimit, notat hidhen në sistemin Pitagora. Pas hedhjes në procesverbal, këto dokumenta arkivohen sipas Rregullores "Për qarkullimin dhe arkivimin e dokumentacionit të brendshëm".</p> <p><i>Evidencë 127. Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më</p>	<p>UAMD ka hartuar një procedurë për ankimimin e notës. Studentët kanë të drejtë të kontestojnë rezultatet e provimit të ndërmjetëm dhe ato të provimit përfundimtar jo me vonë se tre</p>

<p>pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>ditë nga dita e publikimit të rezultatit. Janë të përcaktuara disa arsye për ankimim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gabim matematikor</li> <li>- Nota nuk reflekton performacën gjatë kursit</li> <li>- Nota nuk reflekton kërkesat e përcaktuara në syllabus</li> <li>- Arsye të tjera</li> </ul> <p>Në rast pranimi të kërkesës e cila i dërgohet Dekanatit, institucioni ngre një grup Ad-hoc për rishikimin dhe vlerësimin e ankesës. Në rasti se kërkesa refuzohet, studenti njoftohet për vendimin. Kur kërkesa pranohet, komisioni ad-hoc rishikon në prani të studentit dhe personelit akademik tezën, për të cilën mbahet edhe procesverbal. Në këtë proseverbal arsyetohet nëse bëhet ose jo ndryshimi i vlerësimi dhe arsyet shoqëruese për çdo ndryshim.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf. Kreu III. Neni 70</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive shtrihet gjatë gjithë vitit akademik, parashikuar edhe në syllabuset e lëndëve/moduleve nga profesorët. UAMD nuk lejon plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra nga studentë t. UAMD përdor sisteme elektronike si Clean Score ruhet anonimati i studentëve dhe teza korrigjohet me kodin unik për çdo student.</i></p> <p>Studentët kanë mundësi të marrin komente/feedback për detyrat apo vlerësimet si dhe kanë të drejtën e ankimimit të vlerësimit, sipas rregulloreve të UAMD. Ankimimet apo kërkesat merren në shqyrtim nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm që garanton një process transparent.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p style="text-align: center;"><b>X</b></p>




**Standardi III.4**

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Në Masterin Profesional “Mësues për Arsim Fillor” thellimi i njohurive, dhe zhvillimi i aftësive profesionale realizohet jo vetëm gjatë dy viteve akademike, por edhe gjatë orëve të praktikës të shtrira në semestrin e dytë dhe të katërt, të cilat zhvillohen në klasat fillore të shkollave 9-vjeçare. Studentët që ndjekin këtë program studimi pajisen me njohuri të thelluara mbi metodat mësimdhënies për klasat I-V, zhvillojnë mendimin e tyre kritik dhe kreativ, punojnë në mënyrë të pavarur dhe bëhen të përgjegjshëm për mësimnxënien, përditësojnë aftësitë e tyre kërkimore. Gjatë programit të studimit ata kanë mundësi të praktikojnë njohuritë teorike gjatë zhvillimit të praktikës në shkollat 9-vjeçare. Nga biseda me përfaqësuesin e Zyrës së Karrierës u informuam se pjesa me e madhe e studentëve të diplomuar janë punësuar në proflin e tyre në shkolla 9-vjeçare publike ose private pas zhvillimit të stazhit të detyrueshëm dhe pajisjes me licensë për të dhënë mësim.</p> <p><i>Evidencë-67 -Marrëveshje Bashkëpunimi me ZVA-Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Është për t’u vlerësuar fakti që programi jep njohuri studentëve në lëndë të shkencave humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit si: Komunikimi dhe Etika, Shkenca e Edukimit, Lidershipi në Edukim, Pedagogji Sociale, Edukim Qytetar Demokratik. Njohuritë mbi teknologjinë përfaqësohen nga Teknologjia në Edukim.</p> <p>Moduli Metodat e kërkimit Shkencor në Edukim, përditëson aftësitë e studentëve për të zhvilluar mendimin kritik dhe kryerjen e analizave të thelluara për problematika që lidhen me profesionin e tyre. Referuar planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstaton se lënda <i>Teknologjitë në Edukim</i> ofrohet si një Lëndë me Zgjedhje (Lëndë Ndërdisciplinore Integruese), ndërkohë që aftësia e përdorimit të teknologjisë është një nga 7 aftësitë kryesore që një student duhet të njohë e</p>

	<p>të përdorë. GVJ është e mendimit se një lëndë e tillë duhet të ofrohet të paktën si Lëndë Karakterizuese. Referuar Literaturës së Detyruar dhe asaj të Rekomanduar në planin mësimor, vihet re se tituj e librave janë pothuajse të gjithë në gjuhën angleze ndaj e marrim të mirëqënë faktin se niveli i përdorimit të gjuhës angleze është i lartë. Nuk ka evidencë ose informacion nëse ndonjë lëndë zhvillohet në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Evidencë 34- Plani Mesuesi arsim fillor. MP 2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Referuar raporteve vjetore të punës të Departamentit të Pedagogjisë, shihet se është bërë një analizë e detajuar e punës si në lidhje me mësimdhënien ashtu dhe me kërkimin shkencor dhe angazhimin e stafit në konferenca apo botimet e tyre në revista të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe pjesëmarrja e stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare .</p> <p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, GVJ evidenton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të përfshira në programin e studimit analizohen në Raportin e vlerësimit të studentëve të diplomuar, të hartuar nga NJSBC, i cili i vihet në dispozicion organeve drejtuese të fakultetit, si edhe Përgjegjësit të Departamentit të Pedagogjisë.</p> <p>Në përfundim të çdo lënde pedagogët u rikthehen qëllimeve dhe objektivave të parashikuara nga ata për kursin, dhe së bashku me studentët ata reflektojnë se çfarë ka funksionuar dhe çfarë mund të rregullohet. Mbi bazën e këtyre reflektimeve profesorët bëjnë ndryshime deri në masën 20% të sillabuseve për vitin tjetër akademik.</p> <p>Gjithashtu, GVJ konstaton referuar RVB, se personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre duke zhvilluar diskutime në përfundim të lëndëve përkatëse.</p> <p><i>GVJ sygjeron që në raportin e departamentit të bëhen dhe analiza të tjera ku të analizohen aspekte të ndryshme si kalueshmëria, nota mesatare, materialet e përdorura në mësimdhënie, përfshirja e ekspertëve vendas për konkretizim me</i></p>






	<i>raste studimore nga vendi, në kuadër të lëndëve të veçanta të programit.</i>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Referuar Raporteve vjetore dhe Ngarkesës mësimore 2020-2023, GVJ konstaton se stafi akademik mbulon lëndë në fusha ku ata janë ekspertë.</p> <p>Duke qenë se studentët janë të detyruar të frekuentojnë programin e studimit në masën 75% ata kanë mundësi të jenë aktiv gjatë orëve të mësimit, të shprehin mendimet e tyre lirshëm (referuar bisedës me grupin e studentëve), të kenë mundësi të punojnë në mënyrë individuale apo në grup, të zhvillojnë mendimin e tyre kreativ dhe inkurajohen për të patur ide sa më inovatore. Referuar dokumentacionit kostatojme se stafi akademik dhe studentët janë të angazhuar në mobilitete Erasmus + si për trajnime ashtu edhe për mësimdhënie në universitetet partnere. Pedagogët e programit të studimit janë të angazhuar si partnerë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu konstatojmë se profesorët janë të angazhuar me kumtime në Konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe sikurse e kemi përmendur edhe më parë UAMD mbështet financiarisht stafet akademike për pjesëmarrje në konferenca apo i krijojnë mundësinë e botimeve në revista ndërkombëtare të rankuara në Scopus dhe/ose Faktor Impakti.</p> <p><i>Evidencë 53 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të UAMD-s.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 68. Mobilitet e stafit akademik dhe studenteve D.Pedagogjise.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në RVB dhe vizitën në institucion, GVB mendon se orët e hapura si dhe seminareve të ndryshme në funksion të programit të studimit janë shumë të rëndësishme në funksionimin e programit të studimit. <i>Evidenca 69</i> në lidhje me listën e leksioneve të hapura mbështetur në RVB, mungon tek dokumentat ashtu si dhe disa Evidencë të tjera.</p> <p>GVJ <u>nuk ka ndonjë informacion</u> mbi këtë rubrikë dhe nuk mund të shprehet qartë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara</p>	<p>Referuar aktiviteteve të kryera nga studentët GVJ vë re se janë zhvilluar trajnime në kuadër të projekti "Debating Economics" (2020-2023), trajnime ku debati trajtohet ndryshe duke i mësuar</p>




<p>kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>studentët të mendojnë në mënyrë kritike për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe për të rritur besimin e tyre për t'u përfshirë në ligjërmin publik dhe si qytetarë aktivë. Bazuar në dokumentat e dorëzuara nga institucioni, personeli akademik me kohë të plotë i Departamentit të Pedagogjisë, ka realizuar botime shkencore, ka marrë pjesë në projekte të financuara nga jashtë si dhe nga vetë UAMD. Pedagogët efektiv të departamentit kanë realizuar prezantime në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Nuk ka dokumentacion që tregon përfshirjen e studentëve në këto aktivitete.</i></p> <p><i>Evidencë 147. Kalendari i Aktivitetet Studentore.pdf</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Konstatohet se, programi i studimit, i ka kushtuar rëndësi të veçantë formimit të njohurive analitike të studentëve, aftësive kërkimore, vlerësimin kritik, duke i bërë ata më konkurrues në treg. Mungonë informacione për leksione të hapura apo lektorë të ftuar nga fusha e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X	

**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Provimi i formimit ose mbrojtja e diplomës shënon dhe përmbylljen e ciklit të studimit. Mbrojtja e temës bëhet kur studenti ka dëshirë dhe paraqet një kërkesë me shkrim në Departamentin e Pedagogjisë, për temën që kanë përzgjedhur dhe pedagogun që do t'i udhëheqë. Vetëm studentët që përmbushin kriteret mund ta mbrojnë diplomën me temë. Lista e studentëve të përzgjedhur Kjo listë miratohet nga Dekanati</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli</p>	<p>Punimi i diplomës është lëndë me detyrim që paraqet punën individuale të studentit, e cila demonstroi aftësitë analitike dhe</p>

<p>akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>njohuritë teorike të përfituara nga studenti. Puna e studentit monitorohet dhe mbështet nga pedagogu udhëheqës i cili sheh propozimin fillestar të punimit, ashton në përpilimin e pyetjeve kërkimore/hipotezave, literaturën e përzgjedhur, metodat dhe instrumentet që do të përdoren, shkrimin e rezultateve dhe të përfundimeve. Gjatë gjithë kohës së shkrimit të punimit udhëheqësi jep sygjerrime, udhëzon dhe ndihmon deri në përfundim të temës. Studentët mund t'i referohen edhe Manualit për shkrimin e temës.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf. Kreu III. Neni 70.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 100 - Manual për punimin e diplomes Master Fakulteti i Edukimit UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion GVJ konstaton se studentët që përmbushin kriteret paraqiten në mbrojtjen e Diplomës përpara Komisionit të Mbrojtjes së Diplomës, i përbërë nga pedagogë të Departamentit të Pedagogjisë. Studentët vlerësohen për:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vetëdijen profesionale në trajtimin dhe analizat e rezultateve dhe përfundimeve</li> <li>2. Përdorimin e metodologjisë shkencore</li> <li>3. Orgjinalitetin e punimit</li> <li>4. Dobinë e punimit</li> <li>5. Cilësisinë e të shkruarit</li> <li>6. Paraqitjen teknike</li> <li>7. Cilësiësinë e prezantimit</li> </ol> <p>Nëse studentët e përmbyllin ciklin e studimeve me provim, përzgjidhi nga banka e pyetjeve të përgatitura më parë nga pedagogët përgjegjës për lëndët, pyetjet që ata duan t'i përgjigjen. Anëtarët e komisionit që përgatisin tezat e provimit të formimit. Përzgjidhen nga Departamenti i Pedagogjisë dhe</p>

	<p>miratohen nga Dekani i FE. Teza firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani miraton.</p> <p><i>Evidencë 118 -Model Formular për Vlerësimin e Temës së Diplomës të studentëve master.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf, Kreu III, Neni 70.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Referuar Manualit punimi i diplomes është një punë kërkimore e cila realizohet në mënyre individuale dhe të pavarur për një çështje a problem nga fusha e arsimit dhe e edukimit në përgjithësi e cila paraqitet për mbrojtje pas përfundimit të programit. Punimi i diplomës paraqet punën individuale të studentit, e cila demonstroi aftësitë analitike dhe njohuritë teorike të përfituara nga studenti. Puna e studentit monitorohet dhe mbështet nga pedagogu udhëheqës i cili sheh propozimin fillestar të punimit, asiston në përpilimin e pyetjeve kërkimore/hipotezave, literaturën e përzgjedhur, metodat dhe instrumentet që do të përdoren, shkrimin e rezultateve dhe të përfundimeve. Gjatë gjithë kohës së shkrimit të punimit udhëheqësi jep sygjerime, udhëzon dhe ndihmon deri në përfundim të temës. Studentët mund t'i referohen edhe Manualit për shkrimin e temës.</p> <p><i>Evidencë 100 - Manual per punimin e diplomes Master Fakulteti i Edukimit UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Mbështetur edhe në Marrëveshjen që FE ka me DAR Durrës studentët kanë mundësi që gjatë praktikës ose kur ata kanë nevojë të kenë akses në shkollat 9-vjeçare të Durrësit për të kryer studime, krijuar klasa pilot, për të intervistuar për të shpërndarë pyetësorë apo instrumente të tjera që i vinë në ndihmë atyre në shkrimin e temës. Institucioni ofron ambiente ku studentët mund të hulumtojnë literaturë bashkëkohore në sallën e bibliotekës. Gjithashtu, studentët kanë mundësi të aksesojnë edhe bibliotekat virtuale që i janë vënë në dispozicion nga Institucioni.</p>

	<p><i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 86_89. Informacion për Bibliotekën Online.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mënyra e vlerësimit për temën është e njëjtë me vlerësimin që bëhet në të gjitha lëndët e tjera të programit të studimit, në përputhje me përcaktimet e nenet e Rregullores të Programit Master. Notat variojnë nga nota 4 (jokaluese) në 10 (maksimumi i vlerësimit). Në përfundim të këtij procesi, komisioni përpilon një procesverbal i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pasi ka përmbyllur çdo detyrim të Programit të studimit Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor", studenti pajiset me diplomë. Elementët përbërës që janë në dokumentin diplomës, formatin e saj si dhe procedurën e regjistrimit me numrin përkatës saj i përcakton Ministria e Arsimit. Sipas udhëzimeve që vijnë nga Rektorati, diplomat e ciklit të dytë të studimit lëshohen dy herë në vit.</p> <p>Studenti pajiset me një një kopje të plotë të programit universitar që ka ndjekur vetëm me kërkesën e tij/saj. Studenti pajiset me diplomën dhe me Suplemenin e saj, në të cilën paraqiten arritjet e detajuara të studentit përgjatë programit të studimit</p> <p><i>Evidencë 40 - Suplementi (varianti i meparshëm) Mesues per arsim fillor.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Procedura e lëshimit të diplomës përfshin dhe fazën e arkivimit. Procesi i arkivimit të diplomës, listës zyrtare të notave dhe shtojcës së diplomës të të diplomuarve është parashikuar në rregulloren e arkivës të UAMD. Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë nuk lëshohet dublikatë diplome. Kopje elektronike e tyre ruhet në sekretarinë mësimore. Pranë sekretarisë mësimore mirëmbahen dhe ruhen në mënyrë të përhershme Regjistrat Themeltar (Amzat), Regjistrat e arritjeve akademike dhe Regjistrat e lëshimit të diplomave.</p> <p>Diplomat e Masterit Profesional regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve.</p>

	<i>Evidencë 138 Rregullore e sekretarise FE.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	GV konstaton se procedurat e ndjekura nga institucioni, lidhur me detyrimet përmblyëse të studentit në programin e studimit, janë të dokumentuara, të mbështetura në kuadrin ligjor në fuqi dhe të zbatuara në përputhje me të. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës dhe i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.			
<b>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Standardi III.6</b>				
<b>Në rastin e programit të studimit në Master Profesionalinstitucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore Durrës të shprehur në një marrëveshje të përbashkët, Departamenti i Pedagogjisë siguron për studentët e këtij programi mundësinë për realizimin e praktikës profesionale në shkollat publike 9-vjeçare, në klasat e arsimit fillor. Studentët kanë mundësi të praktikojnë njohuritë e përfutura gjatë dy viteve akademike në klasa me grupmoshat reale. Praktikat mund të jenë fillimisht pasive ku studentët kanë mundësi të observojnë Mësuesin e klasës si ndërvepron me nxënësit, si shpjegon mësimin, si manaxhon klasën, kohën resurset etj. Më pas studentët kanë mundësi të kryejnë praktika aktive ku ata vetë do të japin mësim dhe më pas do të marrin dhe feedback nga Mësuesi i që do t'i ndjekë gjatë zhvillimit të praktikës.			
	<i>Evidencë 102. Rregullore e praktikës profesionale.pdf</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe	Ashtu sikurse citohet dhe në kriterin më sipër, GVJ vlerëson bashkëpunimin e UAMD me ZVA Durrës për ndjekjen e praktikës në shkollat publike për studentët e këtij programi studimi. Referuar vizitave në Institucion GVJ mori informacion se studentët kanë mundësi të praktikojnë aftësitë e tyre			



teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	mësimdhënëse me klasat I-V edhe në shkollat pilot të cilat janë të pajisura me laboratorë kompjuterash dhe mësojnë edhe si të kodojnë me anë të pajisjeve koduese.			
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Për t'i ardhur në ndihmë studentëve që nuk jetojnë në Durrës DP i krijon mundësinë të zhvillojnë praktikant profesional edhe pranë rretheve të vendbanimit të tyre. Në këtë rast, studenti që e ka këtë nevojë duhet të depozitojë më parë një kërkesë me shkrim në sekretarinë mësimore. Praktikant që zhvillohen në dy vite akademike vlerësohen me 12 kredite, 6 kredite secila. Për secilën praktikë studentët kanë 75 orë punë individuale, për t'u përgatitur për mësimdhënie dhe për të plotësuar dosjen e praktikës. Vlerësimi i studentit për lëndën e praktikës bazohet në shqyrtimin e dosjes së praktikantit, e cila përmban "Vlerësimin e praktikantit" nga mentori dhe portofolin e praktikantit.  <i>Evidencë 102. Rregullore e praktikës profesionale.pdf</i> <i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton se institucioni, zbaton një procedurë të qartë për praktikant profesional dhe siguron për studentët e këtij programi mundësinë për realizimin e praktikës profesionale në shkollat publike 9-vjeçare, në klasat e arsimit fillor, në bashkëpunimi me DAR Durrës. Vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e dosjes së praktikantit, e cila përmban "Vlerësimin e praktikantit" nga mentori dhe portofolin e praktikantit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Standardi IV.1**

**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

**Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Në vitin akademik 2022 -2023, Departamenti i Pedagogjisë, që është njësia bazë ku zhvillohet Programi i studimit ka patur në përbërjen e tij 13 Personel Akademik Efektiv (PAE), 0 Personel Akademik me Kontratë (PAK) dhe 1 Personel Ndihmës Akademik dhe Administrativ.

Në tre vitet e fundit akademike kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve.

Kualifikimi i stafit	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-	1	-
Prof.Asoc.	4	2	5	1	7	
Dr./PhD	6	1	6	-	5	-
MSc	-	-	-	-	-	-
<b>Total</b>	<b>11</b>	<b>3</b>	<b>12</b>	<b>1</b>	<b>13</b>	<b>0</b>

Nga sa më sipër konstatohet se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi i përmbush kërkesat ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë, nr. 80, 2015, neni 59) për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi) në lidhje me gradat shkencore.

Referuar syllabusit të programit mësimor Master Profesional në “Mësues për Arsim Fillor” rezulton se në mësimdhënien e 18 lëndëve (14 D dhe 4 Z) të këtij programi janë angazhuar 12 PAE, ku 4 prej tyre japin dy lëndë. Referuar ngarkesës vjetore 2022-2023, Nje staf nuk figuron fare si pjesë e stafit PAE të

DP, ndërkohë që te syllabusi figuron si mësimdhënëse e lëndës “Psikologji Edukimi”.

Pra, vërehen mospërputhje në evidencat e ndryshme, për të njëjtin vit akademik, të paraqitura nga institucioni lidhur me stafin akademik PAE të angazhuar në mësimdhënie, si përsa i përket departamentit në përgjithësi, ashtu edhe programit MP-AF në veçanti. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është bërë në përputhje me karakteristikat ndërdisiplinore të programit të studimit dhe kualifikimeve specifike të tyre dhe të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi.

Lidhur me kërkimin shkencor në departament, referuar evidencave të vëna në dispozicion nga institucioni, rezulton se stafi akademik është angazhuar në veprimtari shkencore si pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, botime apo pjesëmarrje individuale në projekte me partnership. Nga evidencat dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët, rezulton se, aktualisht, nuk ka një fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Nuk ka projekt shkencor në departament apo shkollë doktrate, brenda fushës specifike të programit MP - AF, ku të jenë të ngazhuar studentët apo stafi akademik, por ka një vendimmarrje të departamentit për të hapur programin e ciklit të tretë Doktoratë në “Shkenca Edukimi” si diploma e dyfishtë me Universitetin e Krakovit Poloni.

*Evidencë 121-ANALIZË VJETORE 2021-2022.pdf*

*00 Listat ASCAL 24.pdf*

*Evidencë 50 “Numri personelit akademik efektiv në njësinë bazë”*

*Evidencë 52.1 Tabela e ngarkesës vjetore për vitin 2021-2022 f-t.pdf*

*Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mesimore e personelit akademik 2022-2023.pdf*

*Evidencë 52.2 Ngarkesës vjetore 2022-2023.pdf*

	<p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kerkimit shkencor FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 148_149 Vendim hapja e programit te ciklit te trete.pdf</i></p> <p><i>Tabelat e MAF. Tabela "Të dhëna për stafin akademik 2022 - 2023</i></p> <p><i>"MAF Syllabuse"</i></p> <p><i>Tabelat e MAF.pdf. Tabelës 2.1 "Cilësia e stafit të mësimdhënies në programin MAF për vitin akademik 2022 – 2023"</i></p> <p><i>5 "CV Stafit Akademik"</i></p> <p><i>3. "MAF Syllabuse.</i></p> <p><i>5.1 Raporti Vjetor i Depattamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 52.1 Tabela e ngarkeses vjetore per vitin 2021-2022 f-t.pdf</i></p> <p><i>3.1.1.5 Rregullore e Prog. MP-MAF.</i></p> <p><i>111 - Raport vjetor i kerkimit shkencor FE 2021-2022, Fq. 15</i></p> <p><i>111 - Raport vjetor i kerkimit shkencor FE 2021-2022, Fq. 16, 18</i></p> <p><i>Tabelat e MAF.pdf. Tabela 21.1 "Plani mësimor lidhur me personelin akademik përkatës", për programin MAF, për vitin 2022 -2023</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngar-kesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p><b>Angazhimi i stafit akademik në këtë program studimi është bërë në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi dhe është rregulluar me akte të brendshme të insitucionit.</b></p> <p><b>Ngarkesa mësimore e stafit akademik është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, ajo mbulohet 95 – 100 % nga stafi akademik efektiv. Ngarkesa mësimore e stafit është shpërndarë në mënyrë të tillë që të mbulojë plotësisht programin e studimit.</b></p> <p><i>Evidencë 1 Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, neni 45,46,47.</i></p>




	<p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>Evidencë 52.1 Tabela e ngarkeses vjetore per vitin 2021-2022 f-t.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mesimore e personelit akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 52.2 Ngarkeses vjetore 2022-2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Stafi akademik është i punësuar sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe akteve rregullatore të brendshme të institucionit. Stafi akademik PAK i kategorisë “Profesor” dhe “Lektor” është i punësuar me kontrata pune me afat të pacaktuar, ndërsa stafi akademik PAE me kontrata me afat të caktuar. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit, PAE i angazhuar në këtë program studimi pothuaj nuk ka ndryshuar.</p> <p><i>Ligji 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i></p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv në njësinë bazë</i></p> <p><i>Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mesimore e personelit akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Depattamentit te Pedagogjise</i></p> <p><i>Evidencë 36. Plani mesimor Programi i Studimit MAF</i></p> <p><i>Evidencë 115. Procedure Rekrutimi</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që</p>	<p>Institucioni ka të rregulluar me akte të brendshme, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, procesin dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik dhe ndihmës mësimor- shkencor, propozohen nga departamenti përkatës. Dekani pasi i verifikon</p>



<p>garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>paraprkishtë dhe i miraton në Këshillin e Fakultetit i përcjell për ndjekje të mëtejshme, të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Sipas nevojave aktuale, shpallet konkursi dhe kryhet publikimi i njoftimit Për shpalljen e vendeve të lira të punës për personel akademik” në Buletinin e Njoftimeve Publike. Njoftimet publikohen në faqen zyrtare të universitetit së bashku me formularët e aplikimit. Punësimi realizohet me procedurë të konkurimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Procedurat e mëtejshme të përzgjedhjes së kandidatëve dhe shpalljes së fituesve janë ta përcaktuara në aktet rregullatore dhe të pasqyruara në aktet raportuese të insitucionit.</p> <p><i>1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>2. Plani i Zhvillimit Strategjik te UAMD 2020-2025</i></p> <p><i>3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.</i></p> <p><i>115. Procedure Rekrutimi</i></p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/chrome-extension://efuidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/FormularAplikimi_Akademik-1">https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/chrome-extension://efuidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/09/FormularAplikimi_Akademik-1</a></i></p> <p><i>16-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Fakukteti i Edukimit ofron auditorë mësimorë të pajisur me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për zhvillimin e mësimdhënies interactive. Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” nuk ka të parashikuar orë laboratorike dhe nuk kërkon mjedise/mjete mësimore specifike. Kapacitetet e përgjithshme të UAMD dhe infrastruktura në funksion të programit të studimit, mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjen me ZVA Durrës, praktikat mësimore kryhen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, pra jashtë mjediseve të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 73. Infrastruktura ne funksion te programit te studimit</i></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p><i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës</i></p> <p>Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit mbledhen, ruhen dhe përditësohen rregullisht dhe janë të detajuara për sa i përket përfshirjes së anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në program, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p> <p><i>Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv në njësinë bazë</i></p> <p><i>Evidencë 44 Ngarkesa mesimore e Personelit Akademik - Departamenti i Pedagogjise 2020-2021</i></p> <p><i>Evidencë 44.1 Ngarkesa Mësimore e Personelit Akademik 2021-2022</i></p> <p><i>Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mësimore e personelit akademik 2022-2023</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjise</i></p> <p><i>Tabelat e MAF. Tabela "Të dhëna për stafin akademik 2022-2023"</i></p> <p><i>Tabelat e MAF. Tabelës 2.1 "Cilësia e stafit të mësimdhënies në programin MAF për vitin akademik 2022 – 2023"</i></p> <p><i>Tabelat e MAF. Tabela 21.1 "Plani mësimor lidhur me personelin akademik përkatës", për programin MAF, për vitin 2022 -2023</i></p> <p><i>MAF Syllabuse"</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me ZVA Durrës, e cila mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve pranë shkollave publike/jopblike, të parashikuar në planin mësimor.</p> <p><i>67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.</i></p>

profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	36. <i>Plani mesimor Programi i Studimit MAF.</i>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme zhvillimin e praktikave profesionale. Referuar planit mesimor të programit të studimit, studentët duhet të kryejnë praktikën mësimore në shkollat publike/jopublike të arsimit parauniversitar, e cila ndiqet nga 1 staf akademik PAK, bazuar në marrëveshjen me ZVA Durrës (e cila duhet rilidhet). Studentët praktikantë zhvillojnë takime të rregullta në auditor me lektorin udhëheqës (30 orë). Në përfundim të praktikës pedagogu udhëheqës bën vlerësimin përfundimtar.  <i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës</i> <i>Evidencë 100. Manual i praktikës profesionale.</i> <i>Evidencë 31 Dosja e praktikës MAF.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor", i përmbush plotësisht kriteret e standardit IV.1. Departamenti i Pedagogjisë dhe UAMD duhet të përmbushin kërkesën për hapjen e shkollës së doktoraturës brenda fushës specifike të programit MAF, ku të jenë të ngazhuar studentët apo stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**


**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr. 1, Kampusi Universitar, Spitalë. Në funksion të realizimit të procesit mësimor janë 15 auditorë me kapacitet total 1141 vende dhe me sipërfaqe 1374.2 m<sup>2</sup> dhe 1 laborator me kapacitet 64 vende dhe sipërfaqe 81.8 m<sup>2</sup>. Gjithashtu, ka në dispozicion 16 zyra me sipërfaqe totale 483.9 m<sup>2</sup>. Për aktivitete të ndryshme disponon sallë konferencash me kapacitet 218 vende me sipërfaqe 192.2 m<sup>2</sup>. Fakulteti ka në dispozicion bibliotekë me kapacitet 126 vende, me sipërfaqe 238.8 m<sup>2</sup>.</p> <p><i>Evidencë 73. Infrastruktura ne funksion te programit te studimit</i></p> <p><i>Evidencë 55 Kapacitetet UAMD_FE</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Fakulteti i Edukimit ofron 2 auditorë mësimorë të pajisur me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për zhvillimin e mësimdhënies interaktive. Programi i studimit Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor” nuk ka të parashikuar orë laboratorike dhe nuk kërkon mjediset/mjete mësimore specifike. Kapacitetet e përgjithshme të UAMD dhe infrastruktura në funksion të programit të studimit, mundësojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjen me ZVA Durrës, praktikat mësimore kryhen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, pra jashtë mjedisëve të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 55 Kapacitetet UAMD_FE.</i></p> <p><i>Evidencë 73. Infrastruktura ne funksion te programit te studimit.</i></p> <p><i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve,</p>	<p>Fakulteti i Edukimit ka 1 laborator me kapacitet 64 vende dhe sipërfaqe 81.8 m<sup>2</sup>.</p>




aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Fakulteti i Edukimit ka 1 laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.  <i>Evidencë 73. Infrastruktura ne funksion te programit te studimit.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.	Bazuar në marrëveshjen me ZVA Durrës, praktikantët mësimorë të studentëve të programit MAF kryhen pranë institucioneve të arsimit parauniversitar, pra jashtë mjediseve të UAMD. Institucioni ka marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit lidhur me mobilitetin e stafit dhe studentëve si për realizimin e praktikave profesionale.  <i>Evidencë 67. Marrëveshje bashkëpunimi ZVA Durrës.</i> <i>Evidencë 53. Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD.</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se mjediset mësimore dhe infrastruktura e vëna në dispozicion janë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit MAF dhe për formimin praktik të studentëve në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien e programit MAF kontribuon në përditësimin e vazhdueshëm të literaturës së nevojshme për zhvillimin e syllabuseve, duke rekomanduar tituj literature apo edhe duke përgatitur dispensa print që i vë në dispozicion të bibliotekës për përdorim të hapur dhe falas nga studentët. Literatura e këtij programi studimi është e kombinuar: literaturë e detyrueshme, përgjithësisht e 15 viteve të fundit, e cila kryesisht jepet në gjuhën shqipe (ose e huaj e përkthyer në gjuhën shqipe), si dhe literaturë e rekomanduar e ofruar përgjithësisht në gjuhën angleze.</p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p> <p><i>Vizita e GVJ në bibliotekën e FE- Aneks/Shtojcë Agjenda e vizitës, MSC. Menaxhim dhe Supervizim i Institucioneve Arsimore, Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Lidhur me përditësimin e literaturës, vihet re një ndryshim dhe përditësim i literaturës për disa nga programet e lëndëve, ndërkohë që ka edhe programe ku nuk vërehet përditësim, duke dhënë literaturë të 20 viteve përpara. Në kushtet kur aksesimi në bibliotekën online jep mundësi për përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit, duhet bërë kujdes që ky përditësim të reflektohet edhe në programin e këtyre lëndëve.</p> <p><i>Evidencë 86_89. Informacion për Bibliotekën Online.</i></p> <p><i>Evidencë 87. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekës</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve</p>	<p>Biblioteka Shkencore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" është bibliotekë publike shtetërore, dhe sipas misionit të saj</p>

<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>klasifikohet në llojin Bibliotekë Universitare. Fakulteti i Edukimit ka në dispozicion bibliotekë me kapacitet 126 vende, me sipërfaqe 238.8 m<sup>2</sup>, me rreth 25 poste për akomodim. Biblioteka siguron shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë në përputhje me rregulloren e bibliotekës.</p> <p><i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekes</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka Shkencore i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet mjediseve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla me fond të hapur. Salla është komode dhe është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve çdo ditë të javës, nga ora 8:00 - 16:00. Në kompjuterat e saj janë instaluar programe specifike për disiplinat e studimit, ku studentët studiojnë. Salla me fond të hapur ofron: literaturë referenciale, periodikun, literaturë print, literaturë prej burimeve elektronike të bibliotekës; literaturë prej burimeve elektronike të huaja; akses në internet;</li> <li>- Fondi i mbyllur. Fondi i mbyllur ofron: Literaturë në gjuhë të huaj, revista, gazeta, fjalorë dhe enciklopedi, arshivën akademike, arshivën digjitale;</li> <li>- Fondi i bibliotekës pasurohet me tituj të rinj nga donatorë të huaj dhe vendas, shtëpi botuese apo individë;</li> </ul> <p>Biblioteka ofron mbi 12 milion artikuj shkencorë, libra, në 75 disiplina të ndryshme</p> <p><i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekes</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Donatorët, shtëpitë botuese &amp; Rrjet network për bibliotekën bibliotekën.</i></p> <p><i>Informacion shtesë nga biblioteka per grupin e akreditimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UAMD është pjesë e RASH gjë që krijon mundësinë e aksesimit në U-Library. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtën e shfrytëzimit falas të mjediseve dhe fondit të bibliotekës. Studentët dhe stafi akademik që janë përdorues të bibliotekës pajisen me kartelën individuale.</p>

	<p><i>Evidencë 86_89. Informacion për Bibliotekën Online.</i></p> <p><i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekes.</i></p> <p><i>Modeli i karteles se perdoruesit.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Sektori i Informatikës mundëson integrimin e teknologjisë së informacionit në Bibliotekën Shkencore. Ai administron dhe kujdeset për funksionimin e mirë të rrjetit të bibliotekës, të dy sistemeve (sistemin e integruar të bibliotekes me programin “KOHA” dhe sistemin e dixhitalizimit “Dspace” si dhe funksionimin të Hardware dhe Softwaret e të gjithë kompjuterave që disponon biblioteka.</p> <p>Në bibliotekë funksionon sistemi i Arkives Dixhitale, duke mundësuar arkivimin dhe ruajtjen në format elektronik të fondit të Bibliotekës, si edhe servirjen e këtij fondi nëpërmjet portalit web. Biblioteka është pjesë e projektit Cobiss, duke përfutur përfshirjen në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë, trajnimin falas të personelit të bibliotekës për një kohë të pacaktuar. Aktualisht sistemi përmban rreth 3000 rekorde të Hedhura.</p> <p><i>Evidencë 87. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është e hapur çdo ditë në orarin 8.00 – 16.00 dhe në ditët e shtuna dhe të diela sipas një grafiku të miratuar dhe të bërë publik. Nga intervista me grupin e studentëve të MAF rezultoi që ata nuk e kishin frekuentuar bibliotekën, pasi nuk e kishin të nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekes.</i></p> <p><i>Evidencë 88. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e</p>	<p>Institucioni e ka të rregulluar me akte të brendshme funksionimin e bibliotekës. Njësia përgjegjëse ka detyrë të ndjekë dhe raportojë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik</p>

shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.  <i>Evidencë 85. Rregullore e Bibliotekes.</i> <i>Evidencë 87. Relacion për aktivitetin e Bibliotekës së UAMD.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se programi i studimit MP - MAF përmban literaturën e nevojshme dhe përgjithësisht të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UAMD disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit për tre vitet e fundit akademike 2020 - 2023. Departamenti i Pedagogjisë disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.


	<p>Të dhënat e studentëve dhe e gjithë ecuria e tyre gjatë ndjekjes së programit të studimit mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe hidhen në regjistrin themeltar dhe në regjistrin e programit mësimor përkatës. Platformat “Sistemi PITAGORA” dhe “Cleanscore” shërbejnë për lehtësimin e menaxhimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Pitagora dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Sekretaria ruan të dhënat në versionin fizik dhe i hedh elektronikisht në sistemin Pitagora. Drejtorja e Administrimit dhe Shërbimeve Skademi, Sektori i Karrierës dhe Alumnit, duke përdorur formularë të dedikuar bën gjurmimim e punësimit të studentëve që janë diplomuar në rang universiteti.</p> <p><i>Evidencë shtesë - Numri i studenteve te regjistruar tre vitet e fundit</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Numri i studenteve te regjistruar tre vitet e fundit.</i></p> <p><i>Evidencë 138 Rregullore e sekretarise FE.</i></p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i perdorimit te Sistemi PITAGORA.</i></p> <p><i>Evidencë 96. Perdorimi i Cleanscore.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Departamenti i Pedagogjisë disponon të dhëna të detajuara, si përsa i përket ngarkesës mësimore të stafit akademik me kohë të plotë ose jo që është i angazhuar në mësimdhënien e MAF, ashtu edhe për numrin e anëtarëve të stafit. Sektori i Burimeve njerëzore mban dosjet e personelit me kohë të plotë, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, etj. Gjithashtu, Sektori i Burimeve Njerëzore mban edhe dosjet e personelit me kohë të pjesshme, me të gjithë informacionin e duhur: CV, diploma universitare, diploma grada shkencore, dëshmi tituj akademikë, vërtetime punësimi, kontrata, etj. Procesi i rekrutimit të stafit është gjithashtu i dokumentuar dhe ruhet në Sektorin e Burimeve njerëzore.</p>






	<p><i>Evidencë 44 - Ngarkesa mesimore e Personelit Akademik - Departamenti i Pedagogjise 2020-2021.</i></p> <p><i>Evidencë 44.1 Ngarkesa Mesimore e Personelit Akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Evidencë 44.2 - Ngarkesa Mesimore e personelit akademik 2022-2023.</i></p> <p><i>Evidencë 50. Numri personelit akademik efektiv ne njesine baze.</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Dokumente me të cilin ngrihet komisioni ad hoc brenda departamentit për rekrutimin e stafit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përmes Sistemit Pitagora, studentët kanë akses në informacioni që lidhet me: kurrikulën e detajuar mësimore, listen e notate dhe kreditet, orarin mësimor, mungesat, faturat dhe pagesat e kryera, regjistrimi në provime. Staf i akademik hedh të dhëna dhe ka akses lidhur me procesin e vlerësimit të studentëve, plotësimin e listëprezencës së tyre dhe listën e studentëve që ndjekin kursin.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit MAF, GVJ ju bë e ditur se ata ose nuk kishin dijeni, ose nuk e përdornin sistemin Pitagora për komunikim të brendshëm.</i></p> <p>Përmes faqes zyrtare të internetit dhe të mediave sociale institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të jashtëm të posaçëm për informimin, këshillimin e aplikantëve për student dhe të studentëve, për cikle dhe programet e studimit që ofron, për fakultetet dhe departamentet, stafin akademik të angazhuar, bibliotekën, kërkimin shkencor, njoftime, etj.</p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit te Sistemi PITAGORA.</i>  <a href="https://fshmt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/MANUAL-PEDAGOGU">https://fshmt.edu.al/wp-content/uploads/2022/02/MANUAL-PEDAGOGU</a>.  <a href="https://uamd.edu.al">https://uamd.edu.al</a>  <a href="https://www.facebook.com/uamdoofficial">https://www.facebook.com/uamdoofficial</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar</p>	<p>Sistemi i komunikimit të brendshëm Pitagora, Sekretaria Mësimore dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe strukturat e tjera</p>

<p>platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>në rang fakulteti mundësojnë ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>UAMD bën analizën vjetore të veprimtarisë së aktivitetit akademik e administrativ të instiucionit. Fakulteti i Edukimit monitoron dhe raporton veprimtarinë shkencore të stafit akademik. Departamenti i Pedagogjisë realizon raportime të rregullta lidhur me veprimtarinë e tij. Sigurimi i cilësisë së brendshme monitorohet, vlerësohet dhe raportohet. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka për detyrë të vlerësojë periodikisht çdo semestër efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore dhe praktikave profesionale, procesin e kontrollit të dijeve, diplomimit, si dhe të veprimtarive administrative dhe financiare të institucionit. Jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i semestrit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i paraqet Rektoratit raportin e vlerësimit semestral.</p> <p>Një formë tjetër e kontrollit të cilësisë së mësimdhënies realizohet edhe nëpërmjet anketimit. Formulari i Anketimit hartohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe miratohet nga Rektorati. Procesi i Anketimit zhvillohet në mënyrë periodike dhe organizohet nga Drejtoria e Informacionit të Teknologjisë dhe e Regjistrimeve. Drejtoria e Informacionit të Teknologjisë dhe e Regjistrimeve brenda 15 ditëve dërgon rezultatet e anketimit tek Njësia e Sigurimit të Cilësisë, e cila brenda 10 ditëve harton raportin e vlerësimit përfundimtar të anketimit dhe e përcjell atë në Rektorat.</p> <p><i>Evidencë shtesë - Raporti Vjetor i UAMD për vitin akademik 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kerkimirt shkencor FE 2021-2022.</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit te Pedagogjise.</i></p> <p><i>Evidencë 129 Raport vleresimi mbi performancen e lektoreve full-time - Departamenti i Pedagogji.</i></p>


	<p><i>Evidencë 16-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE. 2015.</i></p> <p><i>Evidencë 16-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE. 2015.</i></p> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve. Stafit Akademik dhe Administratës.</i></p>			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të UAMD vetëm në gjuhën shqipe.			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Më mirë duhet të punohet në drejtim të njohjes dhe përdorimit të sistemit të brendshëm nga të gjithë studentët dhe pedagogët e programit me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të cilësisë së procesit të mësimdhënies.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë	Fokusi i raportimeve financiare të institucionit është edhe sistemi i krijimit dhe auditimit të të ardhurave dytësore, pjesë e të cilave janë edhe tarifat e shkollimit për çdo program studimi.

<p>përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Departamenti i Pedagogjisë ka për detyrë të paraqesë në dekanat kërkesën për përmbushjen e nevojave financiare të njësisë bazë lidhur me programet e studimit të ciklit të dytë. Kjo pasqyrohet në dokumentacionin e ofruar nga institucioni.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. neni 27, pika 3/f</i></p> <p><i>Evidencë 135. Vendim Bordi Raporti i Auditit te brendshem</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit MAF përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. neni 27, pika 3/f</i></p> <p><i>Evidencë 135. Vendim Bordi Raporti i Auditit te brendshem</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p> <p><i>Evidencë 135. Vendim Bordi Raporti i Auditit te brendshem</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për</p>	<p>Institucioni ka krijuar zinxhirin hierarkik të raportimit lidhur me realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Drejtoria e</p>

<p>programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Administrimit Financiar harton raporte periodike lidhur me realizimin e buxhetit dhe i bën publike në web zyrtar të UAMD.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. neni 27, pika 3/f</i></p> <p><i>Evidencë 135. Vendim Bordi Raporti i Auditit te brendshem</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik te UAMD 2020-2025.</i>  <a href="https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/2.SHKRESA-NR-491-DT-16.03.2023-RAPORTI-DY-MUJOR-2023_page-0002">https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/09/2.SHKRESA-NR-491-DT-16.03.2023-RAPORTI-DY-MUJOR-2023_page-0002.</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Insitucioni ka ngritur strukturat e duhura dhe ka hartuar aktet e brendshme rregullatore që garantojnë qëndrueshmërinë financiare; zbaton procedura dhe ndjek procese vendimmarrjeje në zbatim të kuadrit ligjor përkatës të arsimit të lartë dhe ligjit të buxhetit; bën auditim të rregullt lidhur me situatën e qëndrueshmërisë financiare të programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Evidencë 6. Struktura Organizative e UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/vendime/">https://uamd.edu.al/vendime/</a></p> <p><i>Evidencë 135. Vendim Bordi Raporti i Auditit te brendshem</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se, UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit MP - MAF dhe mbështetjen e studentëve.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni synon ofrimin e programeve bashkëkohore të studimit, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit. Fakulteti i Edukimit aplikon programe studimi zinxhir në fushën e Edukimit – nga cikli i parë Bachelor deri në ciklin e dytë Master Profesional apo Master Shkencor dhe së fundmi me Vendimin e Senatit Akademik për hapjen e Shkollës së Doktoraturës në Fakultetin e Edukimit - duke krijuar qëndrueshmëri dhe vijimësi të studimeve. Lidhur me përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës, rezulton se në vitin 2015, nga Departamenti i Pedagogjisë, pranë Fakultetit të Edukimit, është kryer një analizë e tillë për programin Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”. Ndërkohë, përgjatë 8 viteve në vazhdim të zhvillimit të programit, nuk është kryer asnjë analizë e tregut të punës, e cila do të kishte qenë e domosdoshme konsideruar faktin që situata e tregut të punës dhe kuadri ligjor ka pësuar ndryshime.</p> <p><i>Evidencë 2 Vendim Senati Akademik UAMD. “Për miratimin e planit të zhvillimit strategjik 2020 -2025 të UAMD”, nr.60. dt.26.10.2020. nr.1324 prot.</i></p> <p><i>Evidencë 148_149 Vendim hapja e programit te ciklit te trete.</i></p> <p><i>Evidencë 21 Udhëzuesi i karrierës UAMD 2020</i></p>

	<p><i>Evidencë 25.1 Model Formular Alumni.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.</i></p> <p><i>Evidencë 26.1 Të dhëna ALUMNI për punësimin e studenteve të UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Gjurmimi i të punësuarve për studentët që kanë përfunduar këtë program studimi.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 22 Shoqata Alumni dhe aktivitetet</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.</i></p> <p><i>Evidencë 128 - Studim tregu te punes.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia dhe të drejtat e njëjta në hyrje, për të gjithë kandidatët, garantoohen nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe akteve të brendshme rregullatore të insitucionit. Procesi dhe procedurat e ndjekura në përcaktimin e kriterëve të pranimit në të gjitha ciklet janë të përcaktuara në Statutin e UAMD dhe në rregulloret e programeve të studimit. Lidhur me kuotat e pranimit në programin Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, rezulton që, për vitin akademik 2021 – 2022 institucioni ka planifikuar për të gjitha kategoritë e veçanat (nga 1 për seicilën), ndërsa në vitin 2022 – 2023 kuota ka të planifikuara kuota për kategoritë të huaj, status jetimi, ballkano – egjiptianë dhe aftësi e kufizuar, por jo për trojet.</p> <p>Insitucioni planifikon politika lidhur me gjithëpërfshirjen dhe barazinë në aksesin në edukim.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit parashikon që studentët janë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji. Aplikimi i sistemit të bursave apo reduktimit të tarifës së studimit për grupe të veçanta studentësh, në të dyja ciklet e studimit, është gjithashtu tregues i politikave të barazisë që zbaton institucioni. Cilësia e studentëve në dalje dëshmohet nëpërmjet vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse të studimit si edhe punësimit të studentëve. Institucioni, në përgjithësi dhe Fakulteti i Edukimit, në veçanti, kanë evidenca të qëndrueshmërisë që lidhen me mundësinë që i jep studentëve të ciklit të parë të vijojnë studimet në ciklin e dytë. Sistemi i gjurmimit të të diplomuarve është gjithashtu një instrument që mat cilësinë në dalje. Nga evidencat e vëna në dispozicion, rezulton se ky gjurmim kryhet, por jo sistematikisht dhe jo për të gjithë studentët e diplomuar. Programi Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, ka një kohëzgjatje të</p>

	<p>konsiderueshme, ndërkohë që evidencat e punësimit nuk e pasqyrojnë vijimësinë e gjurmimit. Tregues i cilësisë së programit të studimit është edhe numri i të diplomuarve që punësohen në profilin profesional për të cilin janë diplomuar. Referuar databazës së punësimit të alumnit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, rezulton vetëm 1 i punësuar në që ka përfunduar Programin Master Profesional "Mësues për Arsim Fillor".</p> <p><i>Evidencë 58. Vendimet për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 60 Vendim nr. 36, dt. 20.04.2021 i Senatit Akademik për miratimin e kuotave.</i></p> <p><i>Evidencë 60.2 Shpërndarja e Kuotave të pranimit të studenteve.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 8. Vendim Senati UAMD, nr.47, dt 21.06.2021, nr.838/4 prot. "Mbi miratimin e rregullores për trajtimin e studentëve me aftësi të kufizuar të UAMD"</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.5. Rregullore e programit të studimit MSH_MAF, Kreu IV, neni 23 "Politikat e pranimit", neni 24 "Procedura e pranimit", neni 26 "Dokument acioni i pranimit".</i></p> <p><i>Evidencë 26.1 Të dhëna ALUMNI për punësimin e studenteve të UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve, duke ndjekur procedurat standard dhe duke zbatuar të gjitha shkallët hierarkike të vendimmarrjes. Institucioni dokumenton të gjitha hapat dhe vendimet e marra lidhur me kriteret e pranimit të studentëve. Kriteret përcaktohen duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi E njëjta procedurë ndiqet edhe përsa i përket kuotave të pranimit duke filluar që nga propozimi në njësitë bazë, përcjellja te rektori e deri te miratimi me vendim të senatit akademik.</p> <p><i>Evidencë 57_60 Kriteret e pranimit të studentëve &amp; Shpërndarja e kuotave.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 58. Vendimet për përcaktimin e kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit publikohen në web- in zyrtar të UAMD dhe në faqet e mediave sociale të universitetit. Po ashtu, kriteret dhe kuotat e UAMD për cdo program studimi publikohen edhe në portalin U-Albania, ku jepen dhe shpjegimet përkatëse.</p> <p>Universiteti vë në dispozicion të aplikantëve zyrat e veta të informacionit dhe është shumë aktiv me njoftime në web dhe media sociale.</p> <p><i>Evidencë 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i>  <a href="https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/">https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/</a>  <a href="https://www.facebook.com/uamdoofficial">https://www.facebook.com/uamdoofficial</a>  <a href="https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6">https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit publikohen në web- in zyrtar të UAMDs dhe në faqet e mediave sociale të universitetit. Po ashtu, kriteret dhe kuotat e UAMD për cdo program studimi publikohen edhe në portalin U-Albania, ku jepen dhe shpjegimet përkatëse.</p> <p><a href="https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6">https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=6</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni harton, miraton me vendim të Senatit Akademik dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të kufizuar, për aplikantë me statusin e jetimit. Për programin e studimit MAF nuk rezultojnë të ketë kuota të veçanta të planifikuara për kategoritë ballkano – egjiptianë, të huaj, troje. Lidhur me kuotat e pranimit në programin Master Profesional “Mësues për Arsim Fillor”, rezultojnë që, për vitin akademik 2021 – 2022 institucioni ka planifikuar kuota (nga 1 për secilën) për të gjitha kategoritë e veçanta ndërsa në vitin 2022 – 2023 kuota ka të planifikuara kuota për kategoritë status jetimi, ballkano – egjiptianë dhe aftësi e kufizuar, por jo për trojet.</p> <p><i>Evidencë 8 - Rregullore për Studentët me Aftësi të Kufizura.pdf</i>  <i>Evidencë 57_60 Kriteret e pranimit të studentëve &amp; Shpërndarja e kuotave.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë 60 Vendim nr. 36, dt. 20.04.2021 i Senatit Akademik per miratimin e kuotave.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 60.2 Shpërndarja e Kuotave të pranimit të studenteve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në përgjithësi, institucioni parashikon aplikim nga kandidatë nga shtete të tjera, kriteri është njohja e diplomës paraardhëse në MAS. Për programin e studimit MAF për vitin 2021-2022 ka qenë 1 kuotë, po ashtu edhe për vitin 2022 - 2023.</p> <p><i>Evidencë 57_60 Kriteret e pranimit të studentëve &amp; Shpërndarja e kuotave.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 60 Vendim nr. 36, dt. 20.04.2021 i Senatit Akademik per miratimin e kuotave.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 60.2 Shpërndarja e Kuotave të pranimit të studenteve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtesa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni ka objektiv strategjik edhe aplikimin e parimeve të barazisë, të gjithëpërfshirjes dhe diversitetit si edhe trajtimin e studentëve me bursa financiare duke pasur parasysh studentët nga grupet vulnerabël. Në planin strategjik parashikohet që universiteti do të gjejë burimet financiare për vendosjen e bursave dhe stimujve të tjerë për studentët më të mirë.</p> <p>Në web-in zyrtar të UAMD, në rubrikën Bursa, për vitin akademik 2023 – 2024, gjen të publikuar formularë që duhet të plotësohen nga aplikantët për të përfituar: reduktim nga tarifa e shkollimit për studentë të ciklit të dytë/ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë të cilët i përkasin kategorive në nevojë si dhe trajtimi me bursë studimi sipas kategorive.</p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik te UAMD 2020-2025.pdf</i>  <a href="https://uamd.edu.al/bursa/">https://uamd.edu.al/bursa/</a></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se politikat e hartuara dhe procedurat e ndjekura dhe të zbatuara nga institucioni për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë në</i></p>



	<i>përmbushje të plotë të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve të cilësisë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Institucioni publikon në web-in zyrtar informacionin lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programet e studimit që ofron në të dyja ciklet e studimit;</li> <li>• Kriteret e pranimit;</li> <li>• Lëndët, modulet dhe kreditet që përmban çdo program studimi, midis tyre edhe MAF;</li> <li>• Kalendari akademik për të dyja ciklet e studimit;</li> </ul> <p>Një booklet i përgatitur jep informacion orientues për studimet në UAMD.</p> <p><i><a href="https://uamd.edu.al/menaxhim-dhe-supervizim-te-institucioneve-arsimore/">https://uamd.edu.al/menaxhim-dhe-supervizim-te-institucioneve-arsimore/</a></i></p> <p><i>Evidencë Broshura para Promovimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Broshura pas Promovimit (1).pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidence 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidence 3.1.1.3 Rregullore e Prog. MP-AF.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124. Booklet UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e</p>	<p>Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme përmes:</p>

<p>njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullore e UAMD;</li> <li>- Rregullore e Fakultetit të Edukimit;</li> <li>- Rregullore e programit të studimit MAF;</li> </ul> <p>Siç parashikohet në kuadrin rregullator të sipërcituar, studentëve ju ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.5 Rregullore e Prog. MP-MAF.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit, kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore dhe pragu i kalimit të vitit akademik janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore të insitucionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullore e UAMD;</li> <li>- Rregullore e Fakultetit të Edukimit;</li> <li>- Rregullore e programit të studimit MAF;</li> </ul> <p>Gjithashtu, bazuar në kuadrin rregullator të sipërcituar, vlerësimi i dijeve dhe aftësive është pjesë përbërëse e çdo programi lëndor, ku përcaktohen format e kontrollit të dijeve (me shkrim, me gojë), frekuentimi, kontrolli i vazhduar apo përfundimtar, si dhe tabela me sistemin e pikëzimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit MAF (Kreu 1, neni 17), përcaktohen të detajuara procedura, kriteret dhe sistemi i vlerësimit të studentit të MAF.</p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p>

	<p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1.5 Rregullore e Prog. MP-MAF.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit janë të përcaktuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregullore e programit të studimit MAF;</li> <li>• Rregullore e UAMD;</li> <li>• Plani mësimor i programit të studimit MAF;</li> <li>• Syllabuset e MAF.</li> </ul> <p>Bazuar në dokumentat e sipërcituar dhe më konkretisht te plani mësimor i programit të studimit MAF (Kreu 1, neni 16), diplomimi bëhet duke mbrojtur tezë diplome ose me provim përfundimtar diplomimi. Studentët janë të informuar për të gjithë procedurën duke filluar nga kriteret (nota mesatare), kërkesa që duhet të paraqesin lidhur me regjistrimin, te kriteret, përcaktimi i temave dhe fushave të studimit, caktimi i udhëheqësit shkencor, formati i paraqitjes së tezës, etj.</p> <p>Njësia bazë ka afishuar orare konsultimi të pedagogëve me studentët, sidomos ata në proces diplomimi, duke kryer takime të përjavshme për t'i informuar rreth këtij procesi.</p> <p><i>Evidencë 3.1.1.5 Rregullore e Prog. MP-MAF.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Evidencë 36. Plani mesimor Programi i Studimit MAF.</i></p> <p><i>000 Syllabuse MP Arsim Fillor 2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 19 Rregullore diplomimi FE new.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informacioni i detajuar lidhur me programin e studimit Master Profesional "Mësues për Aesimin Fillor" është i publikuar në web-in zyrtar të institucionit. Informacioni i detajuar përmban përshkrimin e programit të studimi: kriteret e pranimit, kohëzgjatjen, kreditet, llojin e diplomës, objektivat e programit, mundësitë e mëtejshme të studimit dhe të punësimit e të kualifikimit profesional, përmbajtjen kurikulare, mbështetja e studentëve, etj.</p> <p>Gjithashtu, përmes Javës së Orientimit, çdo fillimviti akademik studentët kanë mundësi të kontaktojnë direkt me pedagogët si</p>

	<p>dhe të vizitojnë mjediset dhe infrastrukturën në shërbim të programit të studimit.</p> <p>Guida e Studentit është një dokument i prodhuar nga institucioni dhe i vënë në dispozicion të studentëve (publikuar edhe në faqen zyrtare web të UAMD) që mundëson informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit.</p> <p><a href="https://uamd.edu.al/mp-arsim-fillor/">https://uamd.edu.al/mp-arsim-fillor/</a></p> <p><i>Evidencë 24. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidence Broshura para Promovimit.pdf</i></p> <p><i>Evidence Broshura pas Promovimit (1).pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar akte rregullatore dhe zhvillon praktika të mira lidhur me vënien në dispozicion të studentëve të informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin e studimit MAF</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.3


**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është struktura përgjegjëse për orientimin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Përmes Guidës së Studentit, studentët informohen rreth:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• strukturës organizative dhe autoritet vendimmarrëse në universitet, fakultet dhe departament dhe përgjegjësitë e secilit;</li> <li>• strukturat në ndihmë të studentit:</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• programet e studimit që ofron fakulteti/departamenti, kohëzgjatjen, organizimin e kursit të studimit, kreditet, kërkesat e përmbushjes së detyrimeve, sylabuset e lëndëve, orarin mësimor, etj;</li> </ul> <p>Institucioni ka hartuar një Udhëzues, informacioni dhe ushtrimet e të cilit i vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p><i>Evidencë 21 - Rregullore - Udhëzuesi_i_Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 24. Guida e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Broshura para Promovimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Broshura pas Promovimit (1).pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124. Booklet UAMD.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Guida e Studentit, Rregullorja e Programit të Studimit MAF, Rregullorja e UAMD, Plani mësimor i programit të studimit MAF dhe Syllabuset e MAF janë dokumenta të prodhuara nga institucioni që vihen në dispozicion të studentëve me qëllim informimin për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Përmes Kalendarit Akademik për të dyja ciklet e studimit, që aksesohet edhe online në web-in zyrtar të UAMDs, studentët njihen me sezonet e provimeve, riprovimeve apo të mbartura. Komunikimi i brendshëm midis studentëve, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore supozohet të kryhet përmes sistemit "Pitagora". Por, nga intervista e grupit të vlerësimit të jashtëm me stafin akademik të departamentit dhe studentët, rezultoi se, ose nuk e dijnë që ekziston një sistem i tillë, ose, ata që kishin dijeni për të nuk e përdorin fare.</p> <p>Ndërkohë, Departamenti i Pedagogjisë ka hartuar një orar konsultimi të pedagogëve me studentët për t'ju ardhur në ndihmë këtyre të fundit, por nga intervista me stafin dhe studentët rezultoi që në praktikë nuk funksiononte një gjë e tillë.</p> <p><i>Evidencë 3.1.1.5 Rregullore e Prog. MP-MAF.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p>




	<p><i>Evidencë 3.1.1 Rregullore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 36. Plani mesimor Programi i Studimit MAF.</i></p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i perdorimit te Sistemi PITAGORA.jpg</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Orari i konsultimeve me studentet.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës ka si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe aplikimit për vende pune. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t’u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Nga evidencat e dorëzuara nga Institucioni në lidhje me tregun e punës së zhvilluar për këtë program studimi, apo dhe evidencat në lidhje me punësimin dhe gjurmimin e studentëve Alumni, vihet re se studentët janë të punësuar si Mësuesi në ciklin fillor, dhe i vlerësojnë njohuritë e marra nga ky program studimi. Vlen të përmendim që studimi i tregut të punës duhet përditesuar (institucioni ka dorëzuar studim të bërë në vitin 2013), pasi kushtet dhe nevojat ndryshojné dhe kjo do të ndihmonte stafin akademik për të propozuar ndryshime të ndryshme me qëllim përmirësimin e këtij program studimi.</p> <p><i>Evidencë 21 - Rregullore - Udhëzuesi i Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 24. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Broshura para Promovimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Broshura pas Promovimit (1).pdf</i></p> <p><i>Evidencë 124. Booklet UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 61.2 Mbi Organizimin e Tutorialit_Mentorimit në UAMD_.pdf</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Gjurmimi i të punësuarve për studentët që kanë përfunduar këtë program studimi</i></p>

	<p><i>Evidencë 16.1 Studim tregu model - Master Arsim Fillor 2013.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Gjatë Javës së Orientimit, studentët njihen me profesorët, kurset dhe programet e studimit dhe planprogramin e secilës lëndë. Studentëve u jepen informacione për sezonet e provimeve, metodat e vlerësimit, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Gjatë Javës së Orientimit, studentët njihen me lektorët e tyre mentorë, me të cilët mund të konsultohen gjatë studimeve të tyre si dhe me Sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, ku mund të këshillohen në lidhje me karrierën e tyre dhe të informohen për aktivitete të ndryshme studentore. Ata vizitojnë mjediset dhe infrastrukturën universitare (auditorë, sekretari, Biblioteka, shërbimet e IT-së etj.).</p> <p><i>Evidencë 24. Java e Orientimit dhe Guida e Studentit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Platformat “Sistemi PITAGORA” dhe “Cleanscore” shërbejnë për lehtësimin e menaxhimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Për platformën Pitagora, stafi akademik dhe studentët e intervistuar nga grupi i jashtëm i vlerësimit, u shprehën se, ose nuk kishin dijeni për ekzistencën e tij, ose nuk e përdornin sepse e kishin më të lehtë të komunikonin përmes whatsapp dhe email.</p> <p>Informacioni për kurrikulat, aktivitetet dhe kalendarin akademik publikohen edhe në web-in zyrtar të UAMD dhe janë publikisht të aksesueshme. Platformat “Sistemi PITAGORA” dhe “Cleanscore” shërbejnë për lehtësimin e menaxhimit të sistemit të brendshëm të informacionit. Për platformën Pitagora, stafi akademik dhe studentët e intervistuar nga grupi i jashtëm i vlerësimit, u shprehën se, ose nuk kishin dijeni për ekzistencën e tij, ose nuk e përdornin sepse e kishin më të lehtë të komunikonin përmes whatsapp dhe email. Informacioni për kurrikulat, aktivitetet dhe kalendarin akademik publikohen edhe në web-in zyrtar të UAMD dhe janë publikisht të aksesueshme.</p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit të Sistemi PITAGORA.</i></p> <p><i>Evidencë 96. Përdorimi i Cleanscore.</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se</i></p> <p><i>institucioni ka hartuar akte rregullatore, ka ngritur strukturat përkatëse dhe zbaton praktika të mira për të vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Institucioni të shikojë mundësinë e familjarizimit të stafit akademik me sistemin Pitagora dhe trajnimin e tyre për përdorimin e tij në shërbim të komunikimit të brendshëm me studentët. Gjithashtu, studimi i tregut të punës duhet përditesuar (institucioni ka dorëzuar studim të bërë në vitin 2013), pasi kushtet dhe nevojat ndryshojnë dhe kjo do të ndihmonte stafin akademik për të propozuar ndryshime të ndryshme me qëllim përmirësimin e këtij program studimi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe nga vizitat në institucion, rezulton se universiteti dhe njësi bazë disponojnë dhe mbajnë statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit MAF për tre vitet e fundit akademike 2020 - 2023. Mbajtja dhe administrimi i të dhënave bëhet nga sekretaria mësimore. Procedurat mbi mbledhjen dhe administrimin e të dhënave janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore të institucionit dhe njësisë bazë. Statistikat vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve janë gjithashtu pjesë e raportimeve dhe analizave vjetore të institucionit, fakultetit apo njësisë bazë.</p>

	<p><i>Evidencë shtesë - Numri i studenteve te regjistruar tre vitet e fundit</i></p> <p><i>Evidencë 121-ANALIZË VJETORE 2021-2022.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Departamenti i Pedagogjisë disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> <p>2020-2021 80 studentë; 2021-2022 60 studentë; 2022-2023 45 studentë;</p> <p>Të dhënat e studentëve dhe e gjithë ecuria e tyre gjatë ndjekjes së programit të studimit mbahen nga Sekretaria Mësimore dhe hidhen në regjistrin themeltar dhe në regjistrin e programit mësimor përkatës.</p> <p><i>Evidencë shtesë - Numri i studenteve te regjistruar tre vitet e fundit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 138 Rregullore e sekretarise FE</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Pitagora dhe janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Sekretaria ruan të dhënat në versionin fizik dhe i hedh elektronikisht në sistemin Pitagora.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe</p>	<p>Institucioni ka hartuar akte lidhur me kontrollin periodik për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), si dhe vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 138 Rregullore e sekretarise FE.</i></p> <p><i>Evidencë 127. Rregullore për qarkullimin dhe arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD</i></p> <p><i>Evidencë 93_94 - Manuali i përdorimit të Sistemi PITAGORA.</i></p> <p><i>Evidencë 96. Përdorimi i Cleanscore.</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Njësia bazë harton raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 121-Analizë vjetore 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjise.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka të rregulluar me akte përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Institucioni është angazhuar në përfshirjen e studentëve në vendimmarrje përmes pjesëmarrjes së tyre në Senatin Akademik. Gjithashtu, pjesëmarrja e studentëve në grupet e vlerësimit të cilësisë është një tregues i përfshirjes dhe kontributit të tyre në sigurimin e cilësisë së punës së institucionit. Një nga strukturat e ngritura në institucion është edhe Këshilli Studentor.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni përmes akteve dhe veprimtarive konkrete garanton përfshirje reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme, të studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. Institucioni raporton mbi aktivitetet vullnetare të studentëve të UAMD dhe publikon Kalendarin e Aktiviteteve të Studentëve.</p> <p><i>Evidencë 18 - Ngritja e komisioneve të Vlerësimit të Brendshëm Departamenti i Pedagogjisë.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 25 Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të FE-së .pdf</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vlerësimit të programit nga studentet.docx</i></p> <p><i>Evidencë 146. Përfshirja e studentëve në Senatin Akademik.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 137.1 Vendim këshillat studentor.pdf</i></p>

	<i>Evidencë 137.2 Vendim keshillat studentor.pdf</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Përmes anketës së studentëve që organizon institucioni, studentët përfshihen në vlerësimin e cilësisë së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• veprimtarisë akademike dhe shkencore të stafit akademik;</li> <li>• të infrastrukturës akademike dhe shkencore;</li> <li>• të komunikimit dhe marrëdhënieve;</li> <li>• aksesin në informacion për programet e studimit dhe aktivitetet që zhvillohen në institucion dhe jashtë tij;</li> <li>• metodat dhe mjetet e mësimdhënies; ndihmën dhe mbështetjen e pedagogëve dhe të strukturave të tjera.</li> </ul> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve. Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Përmes instrumenteve matëse dhe vlerësuese të programit të studimit dhe të stafit akademik, studentët japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> <p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve. Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 72 Urdhri i Rektoratit mbi Transparencën e Marrëdhënies Student-Pedagog.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 98 Programi i Transparencës UAMD.pdf</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar politika, akte rregullatore për përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe ka ngritur sistemin dhe strukturat përkatëse për të zbatuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

				X
--	--	--	--	---

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit, përmes Sektorit të Teknologjisë dhe Informacionit, Sektorit të Komunikimit, Alumni dhe Karrierës, Sekretarisë Mësimore dhe Departamentit të Pedagogjisë. Departamenti ka të publikuar në mjediset e tij këndin e informimit për njoftimet dhe të rejat e fundit.  <i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Përmes faqes zyrtare të internetit dhe të mediave sociale institucioni ka ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të jashtëm të posaçëm për informimin, këshillimin e aplikantëve për student dhe të studentëve. Sistemi i komunikimit të brendshëm Pitagora dhe Sekretaria Mësimore mundësojnë ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.  <i><a href="https://uamd.edu.al">https://uamd.edu.al</a></i> <i><a href="https://www.facebook.com/uamdoofficial">https://www.facebook.com/uamdoofficial</a></i> <i>Evidencë 138 Rregullore e sekretarisë FE</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të	Zyra e Karrierës ka si funksion të saj parësor ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe praktika profesionale për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Kjo arrihet nëpërmjet vendosjes së kontakteve me ndërmarrje dhe organizata të ndryshme private, të cilat veprojnë në tregun e punës. Udhëzuesi përgatitur nga kjo zyrë, u vjen në ndihmë studentëve dhe ish-studentëve në procesin e kërkimit dhe

<p>posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>aplikimit për vende pune. Informacioni dhe ushtrimet në të u vlejné studentëve edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga punonjësit e Zyrës së Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.</p> <p><i>Evidencë 21 - Rregullore - Udhëzuesi_i_Karrieres.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 61.2 Mbi Organizimin e Tutorialit_Mentorimit në UAMD_.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Skadematike, Sektori i Karrierës dhe Alumnit, duke përdorur formularë të dedikuar ka bërë gjurmimim e punësimit të studentëve që janë diplomuar në rang universiteti. Shoqata Alumni UAMD mbështet qëllimet e Universitetit dhe punon për të forcuar lidhjet midis ALUMNI-t si komunitet dhe UAMD-së përmes promovimit dhe avancimit të interesave dhe suksesit të ish-studentëve dhe Universitetit "Aleksandër Moisiu". Përfshirja e ish-studentëve të UAMD-së në jetën aktuale universitare realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eventeve dhe aktiviteteve që organizon UAMD;</li> <li>• Promovimit të ALUMNI nëpërmjet programeve edukative, profesionale dhe sociale që ndodhin në UAMD;</li> <li>• Përfshirjes së ALUMNI në programet e ndryshme universitare;</li> </ul> <p>Sigurimi i kontakteve të vazhdueshme midis Alumni dhe Universitetit Aleksandër Moisiu".</p> <p><i>Evidencë 25.1 Model Formular Alumni.</i></p> <p><i>Evidencë 25. Njoftime për punësim të studentëve dhe alumni.</i></p> <p><i>Evidencë 26.1 Të dhëna ALUMNI për punësimin e studenteve të UAMD.</i></p> <p><i>Evidencë 22. Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet.</i></p> <p><i>Evidencë 23 Takime_Raport Shoqata Alumni</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek procedura dhe ka ngritur njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat</p>

	<i>ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Statuti i UAMDs, bazuar në kuadrin strategjik dhe ligjor të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vend, parashikon dispozita të veçanta përsa i përket sigurimit të cilësisë dhe standardeve të kërkuara për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Investimi në cilësinë e mësimdhënies është një përparësi e Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu objektiv i rëndësishëm është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik te UAMD 2020-2025.pdf</i></p>



	<p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Cilësia e mësimdhënies dhe e stafit akademik monitorohet, matet dhe vlerësohet rregullisht përmes mekanizmave të tillë si pyetsori i vlerësimit të performancës së stafit akademik nga studentët dhe formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik. Institucioni dhe Departamenti i Pedagogjisë harton raporte periodike të rregullta lidhur me veprimtarinë e stafit akademik dhe procesin mësimor.</p> <p>Po ashtu, raporti i vlerësimit të cilësisë së brendshme hartuar nga Fakulteti i Edukimit, përmes analizës SWOT, analizon pikat e forta dhe ato të dobëta në punën e departamentit lidhur me programet e studimeve, cilësinë e mësimdhënies, kërkimin shkencor, menaxhimin institucional, etj. Një tjetër instrument është edhe vlerësimi i përgjegjësive të departamentit për çdo anëtar të stafit të tij me kohë të plotë, duke u bazuar në përmbushjen e detyrimeve administrative dhe akademiko-shkencore. Ky pyetësor zhvillohet në fund të semestrit të dytë, brenda muajit Qershor, dhe së bashku me vlerësimin e studentëve i vihet në dispozicion Rektoratit.</p> <p><i>Evidencë 70. Vlerësim i performancës së stafit akademik nga studentet.</i></p> <p><i>Evidencë 116. Model vlerësimi i pedagogut.</i></p> <p><i>Evidencë 71. Formular i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik.</i></p> <p><i>Evidencë shtesë - Raporti Vjetor i UAMD për vitin akademik 2019-2020.</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjisë</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve përmes pyetësorëve anonimë që plotësohen 2 herë në vit. Ky proces zhvillohet nga Sektori i Kurrikulave dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti)</p>

<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p><i>Evidencë 14. Raporti i Rezultateve të anketimit të Studentëve. Stafit Akademik dhe Administratës mbi Institucionin.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>UAMD i përmbahet Standardeve Europiane kryesore për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e SBSC. KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. NjBSC në nivel Fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektivave NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinatorët e programeve. Në realizimin e objektivave të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional. Menaxhimi i zhvillimit të Cilësisë realizohet përmes Proceve të brendshme dhe Proceve të jashtme.</p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E-rishikuar</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të institucionit (UAMD) sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorit të studentëve, të cilët vlerësojnë institucionin;</li> <li>- Pyetësorit të stafit akademik, i cili vlerëson institucionin;</li> <li>- Pyetësorit të stafit administrativ, i cili vlerëson institucionin;</li> <li>- Vlerësimit të drejtuesit të njësisë kryesore për stafin administrativ që ai drejton.</li> </ul> <p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar në modelet e brendshme të UAMD;</li> </ul>

- standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen në kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;
- rregullores së studimeve për çdo program;
- cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin;
- politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;
- infrastrukturës mësimore;
- ndërkombëtarizimit të programeve;
- monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.

Vlerësimi i cilësisë së studentëve sigurohet nëpërmjet:

- kriterëve të pranimit duke respektuar karakteristikat e programit të studimit;
- kriterëve të vlerësimit të studentëve;
- kriterëve të vlerësimit të punimeve të diplomave;
- treguesve të rezultateve të të nxënësve;
- treguesve të shërbimeve mbështetëse për studentët;
- treguesve të punësimit të të diplomuarve;
- mbështetjes së mobilitetit të studentëve;
- njohjes së studimeve.

Vlerësimi i cilësisë së personelit sigurohet nëpërmjet:

- kriterëve të rekrutimit;
- përshkrimit standart dhe specifik të punës;
- treguesve të performancës nga vlerësimi i studentëve dhe eprorit;
- vlerësimit të performancës nga eprori;
- mbështetjes së mobilitetit;
- standardeve të promovimit;
- nivelit të trajnimit.

Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor sigurohet nëpërmjet:

- planit strategjik të kërkimit shkencor;
- procedurës së monitorimit të treguesve dhe të vlerësimit të kërkimit shkencor;
- sistemit të informimit për kërkimin shkencor.

Sigurimi i cilësisë matet përmes të dhënave dhe treguesve të ndryshëm cilësorë dhe sasiorë të cilët analizohen dhe rishikohen nga stukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë në shumë nivele.

	Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit bëhen të ditura përmes raportimeve të NjBSC, njësave bazë dhe fakultetit.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka hartuar dhe ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Struktura përkatëse e sigurimit të cilësisë ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit dhe raporte monitorimi dhe vlerësimi. Fakulteti i Edukimit dhe në mënyrë të veçantë Departamenti i Pedagogjisë, duhet të reflektojnë në raportimet e tyre vjetore udhëzimet e NJBSC lidhur me analizën e cilësisë (SWOT), e cila duhet të bazohet në indikatorë sasiorë të matshëm. Struktura e raportit duhet të bazohet në modelin e ofruar nga NJBSC, me qëllim që të sigurohet njësimi i raportimeve të njësave të ndryshme dhe të ketë një model të vetëm raportimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën në institucion, rezulton se UAMD ka përcaktuar politika, ka ngritur strukturat përkatëse dhe zbaton procedurat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi lidhur me Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025 dhe Statuti i Universitetit (Kreu VII) përcaktojnë qartë vizionin, parimet, strukturat, funksionet procesin dhe procedurat e sigurimit të cilësisë. Më të detajuara i gjejmë në Rregulloren e Universitetit (neni 20 për komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë së institucionit dhe vperimtarinë e tij) dhe Rregulloren për Funksonimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë

	<p>(strukturat përbërëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe përgjegjësitë e tyre, objektivat e SBC dhe menaxhimi, standardet kryesore të SBC, roli dhe funksionet e NjBSC në nivel institucional, roli dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, funksionet e koordinatorit të programit të studimit për SBC, metodologjia e SBC, etj).</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Evidencë 2. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E-rihikuar</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në UAMD është ngritur dhe funksionon sistemi i Sigurimit të Cilësisë, procesi i të cilit është detyrë dhe realizohet nga NJSBC. Në nivel institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati Akademik;</li> <li>- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC);</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC);</li> <li>- Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL);</li> <li>- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC);</li> </ul> <p>Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti);</li> <li>- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.);</li> <li>- Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.);</li> </ul> <p>Fakulteti i Edukimit ka ngritur grupet e vlerësimit të brendshëm për çdo cikël dhe program studimi. Po ashtu, Departamenti i Pedagogjisë ka ngritur grupet e vlerësimit të brendshëm për programet mësimore të tij, midis tyre edhe për MAF.</p>



	<p><i>Evidencë 16-Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE, 2015</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Evidencë Cilesise-E-rishikuar</i></p> <p><i>Evidencë 17. Vendim i FE per ngritjen e GVB.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 18 - Ngritja e komisioneve te Vleresimit te Brendshem Departamenti i Pedagogjise</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. UAMD ka marrë akreditimin e parë institucional në vitin 2016 për 5 vite dhe përsëri në vitin 2021. Program i studimit MAF nuk është akredituar asnjëherë që nga hapja e tij.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programeve të studimit sigurohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit të programeve sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore, duke u bazuar ne modelet e brëndshme te UAMD;</li> <li>- standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit sic përcaktohen ne kornizën europiane të sigurimit të cilësisë dhe kodit të cilësisë;</li> <li>- rregullores së studimeve për çdo program;</li> <li>- cilësisë dhe numrit të kërkuar të personelit akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin;</li> <li>- politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë mësimore bashkëkohore;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- infrastrukturës mësimore;</li> <li>- ndërkombëtarizimit të programeve;</li> <li>- monitorimit, vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit.</li> </ul> <p>Vlerësimi i cilësisë bëhet dhe raportohet mbështetur në standarde cilësie dhe indikatorë sasiorë të matshëm.</p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E-rishikuar</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se UAMD ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së punës në institucion. Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë kanë hartuar dokumenta që mbështeten në politikën dhe strategjinë e insitucionit për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin</p>	<p>Institucioni parashikon procese për hartimin dhe miratimin e programeve që ofron. Programet hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Diploma e dhënë për programin përputhet me nivelin e kornizës kombëtare dhe europiane të kualifikimeve. Institucioni monitoron dhe vlerëson periodikisht programet që ofron dhe garanton se janë përmbushur objektivat e tyre si dhe nevojat e studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime çojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Veprimet e ndërmarra si rezultat i vlerësimit dhe përmirësimit i komunikohen palëve të interesuara. Përmes</p>

<p>e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>përcaktimit të kriterëve dhe afateve të hartimit, ristrukturimit dhe përmirësimit si dhe standardeve dhe kriterëve të cilësisë së programeve të studimit, hartimit të rregullores së programit të studimit MAF, raportimeve për realizimin e programit, raportimeve për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit, ngritjen e strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, etj., insitucioni ka krijuar mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij.</p> <p><i>0000 RVB - MP Mesues per Arsim Fillor Shtator 2023.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NJSBC përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë hartojnë raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit. Raporti i vlerësimit të cilësisë duhet të hartohet çdo vit akademik nga NJSBC, pasi evidenca e vënë në dispozicion të GVJ daton që në vitin 2015. Gjithashtu, të gjitha raportet analizë nuk janë të mbështetura në një analizë SWOT dhe nuk kanë indikatorë sasiorë të përmbushjes së standardeve.</p> <p><i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Depattamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kerkimirt shkencor FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 16 Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE. 2015.pdf</i></p>




<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Siç është përcaktuar qartë në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe siç evidentohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Departamenti i Pedagogjisë, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës. <i>GVJ nuk mund të shprehet, pasi nuk ka evidenca në dispozicion, lidhur me testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, me qëllim vlerësimin e realizimit dhe të garantimit cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p><i>Evidencë Urdhër Rektorati nr.118, date 3.10.2016 për Përshtatjen e Kurrikulave në Programet MP.pdf</i></p> <p><i>Evidencë Urdher nr.20 për Ndryshimin dhe Përshtatjen e Kurrikulave, FE (1).jpg</i></p> <p><i>Evidence 122 Mendimi i Dekanit mbi Programin MP Mesues per Arsim Fillor.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 118 -Model Formular për Vlerësimin e Temës së Diplomës të studentëve master.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin</p>	<p>Siç është përcaktuar qartë në të gjitha aktet e brendshme rregullatore institucionale dhe siç evidentohet nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Departamenti i Pedagogjisë, UAMD përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim në vlerësimin e realizimit dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit MAF.</p> <p><i>Evidencë 116 - Model vleresimi i pedagogut.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vleresimit te programit nga studentet.docx</i></p>

apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<i>Evidencë 71. Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet. Raporti i vlerësimit të cilësisë duhet të hartohet çdo vit akademik nga NJBSC, pasi evidenca e vënë në dispozicion të GVJ daton që në vitin 2015.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që Institucioni dhe departamenti duhet të fillojnë të mbledhin evidenca lidhur me testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, me qëllim vlerësimin e realizimit dhe të garantimit cilësisë së programit të studimit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	NJBSC-ja siguron informacion për cilësinë tek aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të universitetit dhe shpërndarjen e informacionit lidhur me treguesit e cilësisë së institucionit për aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në zbatim të legjislacionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm që ngrihet gjatë procesit të akreditimit të programit nga dekani i fakultetit ku programi ofrohet, përbëhet nga tre përfaqësues të stafit akademik të angazhuar ne programin që i nënshtrohet procesit të akreditimit, një përfaqësues nga studentët i angazhuar në programin që i nënshtrohet procesit të akreditimit, një



	<p>përfaqësues i jashtëm nga institucionet partnere dhe koordinatori institucional.</p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funksonimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar.pdf, neni 11</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në UAMD përcakton, funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi, përmes rregullimit dhe standardizimit të vlerësimit të proceseve. Kjo rregullore synon, përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Rregullorja ka për qëllim, zhvillimin e cilësisë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, miratimit të treguesve të cilësisë në kuadër të “vlerësimit të jashtëm”, si dhe përmes aplikimeve përkatëse të tyre, duke respektuar çdo hap të nevojshëm për këtë proces dhe për çdo proces tjetër që lidhet me cilësinë e institucionit tonë arsimor, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Kjo rregullore, së bashku dhe bazuar në Statutin e UAMD dhe Rregulloren e UAMD, përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funksonimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar.pdf, neni 11</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e</p>	<p>Statuti i UAMD përcakton përfshirjen e strukturave hierarkike të brendshme në procesin e sigurimit të cilësisë, midis tyre edhe njësinë bazë. Statuti garanton mbështetjen e procesit të sigurimit të cilësisë në parimin e transparencës dhe të gjithëpërfshirjes.</p>

<p>studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Rregullorja per Funkzionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilësisë përcakton qartë modalitetet e përfshirjes së njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funkzionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar.pdf, neni 11</i></p> <p><i>Evidencë 70 Formular i vlerësimit të programit nga studentet.docx</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>E gjithë baza rregullatore e UAMD garanton përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duke respektuar integritetin akademik, transparencën, shmangien e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 4. Kodi i Etikës UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 3.1.1 Rregillore e Departamentit te Pedagogjise.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje</p>	<p>Statuti UAMD, Rregullorja e FE, Rregullorja e Departamentit të Pedagogjisë, Rregullorja per Funkzionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilësisë dhe praktika e punës në institucion, sigurojnë pjesëmarrje aktive në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, edhe të bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>

me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>Evidencë 3. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.pdf</i> <i>Evidencë 3.1. Rregullore e Fakultetit të Edukimit.pdf</i> <i>Evidencë 3.1.1 Rregullore e Departamentit të Pedagogjisë.pdf</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Të gjitha aktet rregullatore të UAMD janë publike në faqen zyrtare web dhe media sociale dhe lehtësisht të aksesueshme nga të interesuarit. Organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare web në programin e transparencës.  <i>Evidencë 98 Programi i Transparencës UAMD.pdf</i> <a href="https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/">https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/</a> <a href="https://uamd.edu.al/transparenca/">https://uamd.edu.al/transparenca/</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën	Në UAMD në përputhje me nenin 7 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" është përgatitur programi i transparencës i cili konsiston në përcaktimin e rregullave bazë të organizimit dhe të funksionimit të universitetit në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë. Informacioni i publikuar në rubrikat e faqes

<p>akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>zyrtare synon të bëjë transparencën e veprimtarisë përmes informimit të publikut duke respektuar njëkohësisht edhe politikat e privatësisë në mbrojtjen e të dhënave personale. Në kategorinë e informacionit pa kërkesë përfshihen edhe mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit</p> <p><i>Evidencë 4. Kodi i Etikës UAMD.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 98 Programi i Transparencës UAMD.pdf</i></p> <p><a href="https://uamd.edu.al/programi-i-transparences/">https://uamd.edu.al/programi-i-transparences/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raportet e vlerësimit që hartohen nga NJSBC përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Fakulteti i Edukimit dhe Departamenti i Pedagogjisë hartojnë raporte periodike lidhur me procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku analizohen arritjet dhe mosarritjet, adresohen mangësitë dhe mënyrat e përmirësimit. Program i studimit MAF i është nënshtruar procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë, ku midis të tjerave janë evidentuar edhe pikat e forta dhe të dobëta të tij si dhe janë dhënë rekomandime për përmirësim. Ky program nuk i është nënshtruar procesit të akreditimit.</p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kërkimit shkencor FE 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti) Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.), Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.) vlerësojnë dhe sigurojnë efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të</p>

<p>vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UAMD, duke shërbyer si një garanci e shtuar në kuadrin e SBSC. KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. KPGSC:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcakton standardet e cilësisë institucionale, bazuar në Kodin e Cilësisë dhe eksperiencat pozitive kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ja propozon ato Senatit Akademik për miratim;</li> <li>- Monitoron dhe udhëheq realizimin e standardeve institucionale të cilësisë dhe të programeve të studimit nga strukturat përkatëse;</li> <li>- Monitoron aktivitetin e komisioneve të vlerësimit të brendshëm tek njësitë kryesore dhe në Rektorat;</li> <li>- I propozon për miratim Senatit Akademik raportin e brendshëm të cilësisë së institucionit;</li> </ul> <p>I propozon Senatit akademik për miratim instrumentat e cilësisë, format e publikimit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.</p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit të Cilësisë-E-rishikuar</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Departamentit të Pedagogjisë.</i></p> <p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kerkimit shkencor FE 2021-2022</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për</p>	<p>UAMD, përmes strukturave të ngritura, që janë përgjegjëse për garantimin e cilësisë, si dhe në zbatim të akteve rregullatore përkatëse, ka të parashikuar në aktet e brendshme rregullatore organizimin e veprimtarive periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të</p>



sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>studimit. Një nga instrumentat e përdorur, për të cilin GVJ ka evidencë, është raportimi periodik i njësisë bazë, fakultetit dhe institucionit.</p> <p><i>Evidencë 13 - Rregullorja per Funkcionimin dhe Organizimin e Sigurimit te Cilesise-E-rishikuar</i></p> <p><i>Evidencë 5. Raporti vjetor për vitin akademik 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 5.1 Raporti Vjetor i Depattamentit te Pedagogjise.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 82 - Raport mbi Veprimtarine Mesimore - Shkencore FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 111 - Raport vjetor i kerkimirt shkencor FE 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 16 Raporti i Vlerësimit të Cilësisë së Brendshme FE. 2015.pdf</i></p>
--	--

<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion nga UAMD dhe në bazë të takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni reflekton transparence dhe efektivitet në politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duke i bërë ato publike me qëllim krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</i></p>
--------------------	--

<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional**  
**“Mësues për Arsimin Fillor ” të ofruar nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi, me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave si dhe kërkesave të tregut të punës.
2. Njësia bazë që ofron programin e studimit Master Profesional” “Mësues për Arsimin Fillor” dhe personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e tij përmbushin kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë.
3. Politikat e hartuara dhe procedurat e ndjekura dhe të zbatuara nga institucioni për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit janë në përmbushje të plotë të kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve të cilësisë.
4. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.
5. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka hartuar akte rregullatore, ka ngritur strukturat përkatëse dhe zbaton praktika të mira për të vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.
6. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.
7. Institucioni, njësia kryesore dhe njësia bazë vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.
8. Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë dhe reflekton transparence dhe efektivitet në proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duke i bërë ato publike me qëllim krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

**Pika të dobëta:**



1. Nga evidencat e paraqitura nga institucioni dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit MAF, rezultojnë se aktualisht, nuk ka një fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Nuk ka projekt shkencor në departament apo shkollë doktrate, brenda fushës specifike të programit MAF, ku të jenë të ngazhuar studentët apo stafi akademik. **(Standarti IV.1)**
2. Raportet analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkalla e cilësisë së punësimit të tyre nuk bazohen mbi një analizë SWOT të detajuar dhe konkrete, si dhe nuk shoqërohen me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. **(Standardi V.4)**
3. Institucioni dhe departamenti nuk prodhojnë evidencë lidhur me testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, me qëllim vlerësimin e realizimit dhe të garantimit cilësisë së programit të studimit. **(Standardi VI.3)**

### **Rekomandime**

Në përmbyllje të procesit të vlerësimit të jashtëm të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional "Mësues për Arsimin Fillor" të ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon si më poshtë vijon:

1. Të kryhet kodifikimi i programit të studimit si një përmbushje e një detyrimi ligjor.
2. Të rinovohet marrëveshja me ZVA Durrës si një nga institucionet kryesore për zhvillimin e praktikës profesionale.
3. Të zhvillohet më shpesh studimi i tregut në mënyrë që departamenti të mund të ndryshojë programin e studimit dhe ta përshtasë me kërkesat e kohës (ndryshim deri në masën që i lejon ligji).
4. Departamenti i Pedagogjisë të përmbyllë procesin e hapjes së Shkollës së Doktoraturës fushës specifike të programit MAF për të mundësuar krijimin e një fushe kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.
5. Të trajnohet stafi lidhur me përdorimin e sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (Sistemi Pitagora) dhe promovimin e tij të studentët.
6. Të menaxhohet me kujdes hartimi i evidencave të stafit akademik, të prodhuara nga departamenti, për të siguruar koherencën midis tyre.

**Evaluation's conclusions for the Second Cycle Study Program Professional Master "Primary Education Teacher " offered by "Aleksandër Moisiu" University Durrës**

**Strengths and affirmations**



1. The structure and organization of the study program is in accordance with the national legal and by-law provisions in force, with the educational objectives, the level of qualification according to the National and European Framework of Qualifications, learning outcomes, competencies and labor market requirements.
2. The basic unit that offers the Professional Master's study program "Teacher for Primary Education" and the academic staff engaged in its teaching fulfill the legal requirements and quality standards.
3. The policies drawn up and the procedures followed and implemented by the institution for the admission, selection, progress of students, transfer, recognition, evaluation of knowledge and graduation in the study program, are in full compliance with the legal framework in force and quality standards.
4. University "Aleksandër Moisiu" Durrës makes available learning environments and suitable infrastructure for the implementation of the teaching process of the study program and for practical training, specific to the nature and field of the study program.
5. University "Aleksandër Moisiu" Durrës has drawn up regulatory acts, established relevant structures and implements good practices to make available to students complete and detailed information about the educational objectives, structure, organization, content of the study program, results expected learning and employment opportunities.
6. University "Aleksandër Moisiu" Durrës designs, follows and implements policies and procedures for the admission, selection, progress of students, transfer, recognition, evaluation of knowledge and graduation in the study program.
7. The institution, the main unit and the basic unit make available to the students of the study program complete and detailed information on academic progress, recognition, evaluation of knowledge until the completion of studies and graduation in that program.
8. The institution follows a clear policy for guaranteeing and promoting quality and reflects transparency and effectiveness in the processes and activities for Internal Quality Assurance for the study program by making them public in order to create an Internal Quality Culture.

#### **Weaknesses**

1. From the evidence presented by the institution and from the meeting with the academic staff and students of the MAF program, it appears that currently, there is no research field in accordance with the study program, the nature and the uniqueness of its modules. There is no scientific project in the doctoral department or school, within the specific field of the MAF program, where students or academic staff are engaged. **(Standard IV.1)**
2. Analytical, periodic reports on the profile and quality of incoming and outgoing students, as well as the degree of quality of their employment, are not based on a detailed and concrete SWOT analysis, and are not accompanied by appropriate measures in terms of improvement of these indicators. **(Standard V.4)**



3. The institution and the department do not produce evidence related to local or standardized tests, the results achieved in inter-institutional or national tests, such as the state exam for regulated professions and others, in order to evaluate the realization and guarantee the quality of the study program (**Standard VI.3**)

### **Recommendation**

At the end of the external evaluation process of the Second Cycle Study Program Professional Master "Primary Education Teacher " offered by "Aleksandër Moisiu" Durrës University, the External Evaluation Group recommends the following:

1. To carry out the codification of the study program as a fulfillment of a legal obligation.
2. To renew the agreement with ZVA Durrës as one of the main institutions for the development of professional practice.
3. To conduct market research more often so that the department can change the study program and adapt it to the requirements of the time (change to the extent permitted by law).
4. The Department of Pedagogy to complete the process of opening the Doctorate School in the specific field of the MAF program to enable the creation of a research field in accordance with the study program, the nature and the features of its modules.
5. To train the staff regarding the use of the internal information management system (Pitagora System) and its promotion to students.
6. To carefully manage the drafting of academic staff records, produced by the department, to ensure coherence between them.







FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

